



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË
PËRPUTHSHMËRISË”**

NË BASHKINË DELVINË

Tiranë, dhjetor 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 – 11
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimití í í í í í í í í í í í í í í í í í	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveí í í í í í í í í í í í í í í í í í	4 – 9
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimití í í í í í í í í í í í í .	9 – 11
II	HYRJA	11 – 15
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i>	
	b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i>	
	c. <i>Identifikim i çështjes.....</i>	
	d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	f. <i>Kriteret e vlerësimit.....</i>	
	g. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	h. <i>Metodat e auditimi.....</i>	
	i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	15 – 46
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	15 – 17
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	17 – 46
2.1.	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit”, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.....</i>	17 – 26
2.2.	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”.....</i>	26 – 32
2.3	<i>Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.....</i>	32 – 46
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIME	46 – 53
V.	ANEKSE.....	53 – 59

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonimë
Bashkim OE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operatori Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 01.11.2021 deri në 25.11.2021 realizoj auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike të subjektit Bashkia Delvinë, sipas programit të auditimit nr. 1110/1, datë 01.11.2021 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 30.6.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxheteve; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 2020, mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 ÷pagaö; 401-408 ÷Furnitorë e llogari te lidhura me toö; 467 ÷Kreditore te ndryshëmö; 602 ÷Shpenzime operativeö dhe 230- 231 ÷Investimeö, si dhe me zgjedhje procedurat e prokurimit zbatimi i kontratave të ndërtimit.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, mungesë të të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjyqimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore/administrative.

Me shkresën nr. 2670/22, datë 14.12.2021 (*prot. KLSH nr. 1110/3, datë 16.12.2021*), nga subjekti Bashkia Delvinë janë paraqitur vërejtjet e Projekt Raport Auditimit, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejttimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.2. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	<p>Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, për vitin 2020, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 285,282 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 249,729 mijë lekë ose në masën 88 %, nga transfertat e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 81,891 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 70,496 mijë lekë ose në masën 86 % dhe nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,047 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 45,301 mijë lekë ose në masën 47 %. Nga këto, paga nga 25,662 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 17,297 mijë lekë ose në masën 65 %, Sigurime shoqërore nga 635 mijë lekë janë realizuar në vlerën 0 mijë lekë, shpenzime operative nga 44,009 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 24,445 mijë lekë ose në masën 48 % dhe investime nga 14,441 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 3,211 mijë lekë ose në masën 19 %, kjo për shkak i mosrealizimit të të ardhurave vjetore të cilat nga 81,163 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt për vlerën 38,509 mijë lekë, pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta. Po ashtu në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e palikuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2019 janë në vlerën 63,211,952 lekë ose 30% e buxhetit fillestarë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër Vetëqeverisjen vendore, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, òPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 òPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</p>	I lartë	17-26	<p>Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e Taksave Vendore, të marrin masa në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.</p>
2.	<p>Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2020 janë për vlerën 65,718,098 lekë</p>	I lartë	26-32	<p>Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>nga këto: <i>Llog (401-408) ÷Furnitor e llogari të lidhura me toö</i>, paraqiten në vlerën 2,086,415 lekë dhe detyrime të tjera në llog (467) <i>÷Kreditorë të ndryshëmö</i>, paraqitet në vlerën 63,631,683 lekë, nga të dhënat rezulton se deri me datë 30.09.2021 nga totali i tyre janë likuiduar gjithsej për vlerën 6,111,046 lekë, mbetet për likuidim vlera 59,607,052 lekë, arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave. Gjithashtu u konstatua se nuk janë likuiduar 41 fatura në vlerën 13,264,298 lekë brenda afatit 30 ditorë nga momenti i paraqitjes se tyre, dhe nuk janë likuiduar në 17 raste vlera e plotë e faturave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë nënenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimi i MF nr. 2 datë 06.02.2012 ÷Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitö i ndryshuar, pikat 253,354, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ÷Për shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaö, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ÷Për financat e Vetëqeverisjes Vendoreö neni 40, 48 dhe Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101</p>			<p>pa likuiduara në vite dhe të hartojë grafik likuidimesh, duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 59,607,052 lekë.</p>
3.	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se:</p> <p>a- Gjendja e llogarisë 486 <i>÷Shpenzime të periudhave të ardhshmeö</i> në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 <i>÷Kreditorë të ndryshëmö</i> dhe llogarisë 401-408 <i>÷Furnitor e llogari të lidhura me toö</i> në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,718,098 lekë për faktin se diferenca për vlerën 13,926,794 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 <i>÷Operacione me shtetin (të drejta)ö</i>.</p> <p>b- Llogaria 231 <i>÷Shpenzime në proces për rritjen e AQTö</i> në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 39,960 lekë, kjo për blerje vegla dhe pajisje pune, që i përket llogarisë 214 <i>“Instalime teknike, makineri pajisje, vegla puneö</i>, kur në fakt nga testimi rezulton se, k to pajisje janë bërë hyrje në magazinë pra investimi është kryer pra nuk është investim në proces, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö Kreu II ÷Parimet dhe rregullat</p>	I lartë	26-32	<p>Drejtorja e Financës, Bashkia Delvinë, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llogarinë 231 <i>“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”</i> për vlerën 0 lekë dhe llogaria 214 <i>“Instalime teknike, makineri pajisje, vegla puneö</i>, për vlerën 5,775,840 lekë. - Llogarinë 4342 <i>÷Operacione me shtetin(Te drejta)”,</i> për vlerën 9,237,217 lekë dhe llogarinë 486 <i>÷Shpenzime te periudhave te ardhshmeö</i>, për vlerën 65,718,098 lekë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 5 dhe Aneksi 1, Klasa 23			
4.	<p>Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën sipër, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, janë realizuar gjithsej 14 procedura me fond limit 74,717 mijë lekë dhe vlerë kontrate 70,388 mijë lekë ose me një ulje prej 5.7%.</p> <p>Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit nga 12 procedura me fond limit 74,717 mijë lekë ka vlerësuar për auditim 7 procedura me fond limit 63,629 mijë lekë ose 85% të fondit të prokuruar.</p> <p>Nga auditimi i 7 procedura me fond limit 63,629 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 4 procedura me fond limit 49,717 mijë lekë (të dhëna të paraqitura në pasqyrën Aneks 4.1 të Raport Auditimit), shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:</p> <p>a- Në 2 raste, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kriteret jo sipas llojit të procedurës dhe të paargumentuara</p> <p>b- Në 3 raste, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, ku procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorim me efektiv të fondeve publike në vlerën 39,585 mijë lekë pa TVSH, nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procedurë.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ðPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 47, ðS’kualifikimi i ofertuesve, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës”, neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 26, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 5, neni 66, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”, neni 70 “Lidhja e kontratës”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor, si dhe rekomandimeve të APP</p>	I lartë	32-46	Kryetari i Bashkisë Delvinë, të analizojë shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, për aplikimin e kriterëve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara dhe të shpalljes fitues të OE me kriteret të paplotësuara, duke mos vlerësuar drejt çdo dokument në përmbushje të kriterëve të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve të prokura me vlerë 39,585 mijë lekë.
5.	Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i të Ardhurave Bashkia Delvinë, konstatohet se, në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 236	I lartë	20-26	Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Delvinë, bazuar në nenin 70 pika 3 ðE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorë, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ðPër Procedurat tatimore në R.SHö, i

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>subjekte në vlerën 13,492,487 lekë dhe 2767 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerë 25,033,525 lekë.</p> <p>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI të <i>Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar</i>, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar</p>			<p>ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën 38,526,012 lekë, si më poshtë vijon:</p> <p><i>a-T'u dërgohet bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë me ndryshime.</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektorit i Taksave dhe Tarifave dhe Sektorit Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 të <i>Mospagimi taksave dhe tatimeve</i>.</i></p>

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **Opinion të kualifikuar**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 ó 30.6.2020, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Delvinë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kritere jo të plotësuar, që janë baza për dhënien e një **Opinion të kualifikuar**, duke çuar në përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet (3-E).

OPNIONI I AUDITIMIT:

I. Opinioni i pasqyrave financiare vitin 2020:

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare (PF) të Bashkisë Delvinë, për vitin 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitit 2020, të cilat justifikojnë dhënien e **opinionit të kualifikuar**.

Baza për opinionin e të kualifikuar¹:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit (kap III/2.2) ku jepen përshkrimi i çështjeve për opinionin e kundërt për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti audituar, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe bazë për dhënien e opinionit tonë. (ISA-700/ISSAI-1700).

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Në vitin 2020 edhe pse ka dalë urdhri për inventarizimin e aktiveve për, llogaritë 210 *ōToka, troje, terreneō*, 211 *ōPyje Plantacioneō*, 212 *ōNdërtesa e Konstruksioneō*, 213 *ōRrugë, rrjete, vepra ujoreō*, asnjë nga aktivet nuk janë regjistruar në hipotekë, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

-Në llogarinë 466 *ōKreditorë për mjete në ruajtjeō* vlera prej 8,295,022 lekë, që janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018 të cilave ka kaluar afati i garancisë disave për shumë vite.

-Llogarisë 486 *ōShpenzime të periudhave të ardhshmeō* në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 *ōKreditorë të ndryshëmō* në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 63,631,683 lekë, për faktin se diferenca për vlerën 13,926,794 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 *ōOperacione me shtetin (të drejta)ō*.

-Llogaria. 231 *ōShpenzime në proces për rritjen e AQTō* në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 39,960 lekë, kur në fakt nga testimi kjo llogari duhej të paraqitej në vlerën 0 lekë, pasi investimi për blerje aktivesh është kryer.

¹ *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:*

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

II. Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë për periudhën në auditim 01.01.2020 ó 30.6.2021, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti “**Bashkia Delvinë**”, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por ne disa raste devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret/vlerësim), të përshkruara në paragrafin e bazës për “*Opinionin e kualifikuar*”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura.

Baza për dhënie opinionit të kualifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- *Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*, si dhe ISSAI 30- *Kodi Etik*, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 *Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë prapun e materialitetit në masën 2%, *ku për vitin ushtrimor 2020 vlera e precizonit është 4,495 mijë lekë*, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Mbi përcaktimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike për kualifikim, ku janë evidentuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se operatorët ekonomik të shpallur fitues jo në të gjitha rastet plotësonin kriteret për kualifikim, proceduara të cilat duhej anuloheshin dhe zhvilluar të tjerë me kushte më të favorshme për të garantuar një përdorim më efikas të fondeve publike për vlerën 39,585 mijë lekë.

Nga AK Bashkia Delvinë për hartimin e specifikimeve teknike nuk angazhohej me një komision i veçantë, por hartoheshin nga NJHDT e cila nuk ka në përbërje specialit të fushës në përcaktimin e specifikimeve teknike, të cilat hollësisht janë trajtuar në kapitullin III/2.3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Delvinë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Delvinë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Delvinë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme², nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar

² ISA 200-ISSAI 1200 *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.*

në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH-së, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1110/1, datë 01.11.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.11.2021 deri në datë 25.11.2021, në subjektin Bashkia Delvinë, për periudhën nga 01.01.2020 deri në 30.6.2021, u krye auditimi *mbi Auditimin financiar dhe përputhshmëri të procedurave të prokurimit* nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K. GJ, *Përgjegjës Grupi*
2. P. GJ, *auditues*

a- Objektivi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimi që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

b- Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit u realizua pas analizës së implementimit të kërkesave të MFK, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri në datë 30.6.2021, si dhe do të ketë si fushëveprimi, buxhetin, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare dhe procedurat e prokurimit me fonde publike.

c- Identifikimi i çështjes: Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan drejtimet e auditimit të miratuara sipas Programit të Auditimit, nr. 1110/1, datë 01.11.2021, *mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*, si më poshtë:

Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet

vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 òPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko- financiare të Bashkisë Delvinë.

d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese të Bashkisë Delvinë, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafii drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. të Bashkisë Delvinë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, konkretisht neni 34, pika 6, neni 65, pika 1 dhe neni 91, pika 1.3.

e- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi aktivitetin e Bashkisë Delvinë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

f- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**

Ligji nr. 88/18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 òPër huamarrjen e qeverisjes vendoreò; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 òPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò (me ndryshime); Vendim i KM nr. 783 datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 òPër procedurat standarde të

përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm; Udhëzimi i MF nr. 9, datë 20.03.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitò, etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò (me ndryshime); Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 òPër përgatitjen e buxhetit vendorò; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 òPër buxhetin e vitit 2018ò, pikat 82-91 òDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendoreò; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 òPër buxhetin e vitit 2019ò, pikat 106-110, òDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendoreø

▪ **Në fushën e mbajtjes kontabilitetit dhe hartimit Pasqyrave Financiare:**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006ò, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, date 10.4.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyreò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabëlò; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 òPër procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorialò.

▪ **Në fushën e prokurimeve publike:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar; Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publikò, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 òPër procedurën e prokurimit me vlera të voglaò, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 òPër gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartëò;

▪ **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 òPër Sistemin e Taksave Lokaleò, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, òPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyreò, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, òPër disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.

g- Standardet e auditimit: ISSAI 100 òParimet themelore të auditimit të sektorit publikò, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 òUdhëzues të Auditimit Financiarò; ISSAI 2300 òPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò; INTOSAI GOV 9100 òUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publikò si dhe INTOSAI GOV 9110 òUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshmeò; ISSAI 400 òParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëò, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej

ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 *Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*; si dhe ISSAI 4200 *Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*; INTOSAI *Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*; etj. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

gj- Metodatat e auditimit: Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

I- Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 *Dokumentimi i Auditimit*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë: *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Auditimi në Bashkinë Delvinë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës por jo të përhapura si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime për çdo problematik të konstatuar, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Delvinë deri me datë 25.11.2021, datë e mbylles së punës audituese në terren.

Në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti me shkresën përcjellëse nr. 2994, datë 2.12.2021, janë paraqitur kundërshtitë, të cilat janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion mbështetës, ndërsa për rastet e tjera nuk janë marrë në konsideratë u trajtuan në këtë projekt raport auditimi, i cili ju paraqit subjektit për vërejtje me shkresën nr. 1110/2, datë 6.12.2021.

Nëpërmjet shkresës së Bashkisë Delvinë nr. 2670/22, datë 14.12.2021 (*prot KLSH nr. 1110/3, datë 16.12.2021*), janë paraqitur kundërshtitë e Projekt Raport Auditimi, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion mbështetës. Ndërsa për mangësitë e tjera të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjore gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimit, i cili përcillet subjekti për marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

Bashkia Delvinë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *oPër Vetëqeverisjen Vendoreë* dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *oPër financat e vetëqeverisjes Vendoreë, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Delvinë.*

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Profili i Bashkisë Delvinë

- Bashkia Delvinë është një institucion i rëndësishëm, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *oPër vetëqeverisjes vendoreë* dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *oPër financat e vetëqeverisjes vendoreë.*

Bashkia Delvinë bën pjesë në Qarkun e Vlorës dhe numëron 18074 banorë me sipërfaqe 182.9 Km². Bashkia Delvinë përbëhet nga 22 fshatra të ndara në 2 Njësi administrative respektivisht: Delvinë dhe Vergo. Bashkisë Delvinë me VKM i janë transferuar Pyje dhe Kullota me sipërfaqe 11522.12 ha (*pyje me sipërfaqe 4132.8 ha dhe kullota me sipërfaqe 7389.49 ha*). Nga dhënia me qira e kullotave kjo bashki, për vitin 2017 ka realizuar të ardhura në vlerë 2,783,600 lekë dhe për vitin 2018 ka realizuar të ardhura në vlerë 4,572,700 lekë.



Parimet e auditimit financiar:

Në punën tonë kemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

- **Fushëveprimi i këtij auditimi**, përfshin të gjithë aktivitetin e Bashkisë Delvinë. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përta i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

- **Misioni**, për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit.

III/2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje, me ndryshimet.

Mbi programimin e PBA 2020-2022 dhe programimi i buxhetit vjetor 2020.

Për vitin 2020, titullari i Bashkisë Delvinë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, *“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”*, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ka paraqitur në Këshillin e Bashkisë për miratim PBA 2020-2022 dhe buxhetin e vitit 2020, i cili është miratuar me VKB nr. 36, datë 23.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr. 2015/1, datë 08.01.2020. Projekt buxheti për vitin 2020 janë hartuar konformë legjislacionit të mësipërm, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2020-2022, me shkresë nr. 416, datë 07.02.2020. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2020-2022, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve. Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 11 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2020-2022 janë përcaktuar *“Përshkrimi”* i çdo program, *“Politika e programit”*, *“Qëllimi i Politikës së programit”*, *“Objektivat e politikës së programit”*. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Programimi i shpenzimeve për vitin 2020 i detajuar sipas programeve paraqitet:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2020	
		000/lekë	%
1	Plani.Menaxh.Admin	112,812	54
2	Pastrim gjelbërim	17,970	9
3	Kultura	3,795	2
4	Çerdhet	5,110	3
5	Sporti	5	0
6	Arsimi parauniversitar	25,216	12
7	Arsimi parashkollor	1,894	1
8	Shërbimi Zjarrfikës	15,643	8
9	Ujitje kullim	11,460	6
10	Rrugët rurale	4,799	3
11	Administrim Pyjor	4,485	2
	Shuma	208,183	100

Burimi: Bashkia Delvinë

Ndërsa ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për viti 2020, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike	Viti 2020	
		000/lekë	%
1	Paga dhe sig.shoqerore	110,639	53
2	Shpenzime operative	60,097	29
4	Investime	35,147	17
5	Te tjera 604-609	2,300	1

Nr.	Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike	Viti 2020	
		000/lekë	%
	Shuma	208,183	100

Burimi: Bashkia Delvinë

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave” dhe “sigurimeve shoqërore (600 , 601), llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për Shpenzime të tjera korrente (602-609) llogaritja për programimin e tyre, është bërë bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “investime (230-231), është bërë duke mbajtur në konsideratë tendencën e realizimit të të ardhurave të veta, grandit dhe fondet që vijnë nga buxheti i shtetit dhe ato të FZHR-së.

Për vitin 2020, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 23.12.2019, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, nr. 2015/1, datë 08.01.2020

Burimet e financimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2020, janë si në pasqyrën që vijon:

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2020	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	0	
2	Transfertsë e pakushtëzuar trashëguar viti pasardhës	947	
3	Transferta specifike të Trashëguar	6.654	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	81.163	
	Transfertsë e pakushtëzuar (Granti)	65.565	
5	Transferta specifike	53.854	
6	Paga (600)		94.739
7	Sigurime shoqërore (601)		15.900
8	Shpenzime operative (602)		60.097
9	Transferta (604) Fondi Rezervë		10
10	Inv(230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez		35.147
11	Investime nga FZHR e M. Linjës		0
	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)		1.300
Totali i buxhetit		208.183	208.183

Burimi: Bashkia Delvinë

Për vitin 2020, të ardhurat e veta dhe grand i pakushtëzuar zënë 71% ose në vlerën 147,675 mijë lekë ndërsa 29% janë grante specifike ose në vlerën 60,508 mijë lekë.

-Në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk janë programuar si zë më vete, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2019, janë në **shumën totale 63,211,952 lekë** ose 30% e buxhetit fillestarë, nga të cilat:

60,251,061 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*,

2,690,891 lekë, llogaria 401-408- *Furnitor e llogari lidhura me to*,

Mos programimi si zë më vete në buxhet të detyrimeve të vitit paraardhës, është në **kundërshtim** me kërkesat e nenit 101 të Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit".

Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Për të gjithë periudhën e audituar, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas

strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit, të cilat janë kryer me Vendime të Këshillit të Bashkisë, sipas Vendimeve të Këshillit të Bashkisë si më poshtë:

Për vitin 2020, me Vendim të KB nr. 10, datë 24.02.2020 òPër disa shtesa në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2020ò, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 255/1, prot, datë 04.03.2020, për shtesë në vlerën 13,590 mijë lekë.

Vendim i KB nr. 24, datë 27.07.2020 òPër disa shtesa në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2020ò, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 7838/1 prot, datë 28.7.2020, për shtesën në vlerën 1,768 mijë lekë.

Vendim i KB nr. 40, datë 14.09.2020 òPër disa shtesa në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2020ò, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 930/1 prot, datë 22.9.2020, për shtesën në vlerën 5,000 mijë lekë.

Vendim i KB nr. 45, datë 27.07.2020 òPër disa shtesa në Buxhetin e Bashkisë Delvinë për vitin 2020ò, shprehur ligjshmëria nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1078/1 prot, datë 06.11.2020, për shtesën në vlerën 1,322 mijë lekë.

Për viti 2020, si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, nga 208,183 mijë lekë në fillim të vitit, në fund të vitit është për vlerën 229,863 mijë lekë.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Delvinë ka përfituar ndihma ushqimore, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, **në vlerën gjithsej 1,761,850 lekë.** U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Delvinë, rezulton se Fletëdalja nr. 236, datë 03.06.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr. 15, datë 22.05.2020 për ushqimet në vlerën 128,159 lekë dhe Fletëdalja nr. 205, datë 22.05.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr. 16, datë 03.06.2020 për ushqimet në vlerën 90,948 lekë

Po kështu Bashkia Delvinë për përballimin e situatës COVID-19 për vitin 2020, nga fondi i emergjencave civile prej 4,300,000 lekë ka miratuar fond për ta përdorur në vlerën 1,542,743 lekë kjo e ndarë për ushqime në vlerën 1,108,791 lekë dhe për materiale pastrimi në vlerën 433,952 lekë.

Mbi dokumentacionin mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Delvinë nuk ka procedurë prokurimi për fonde të FZHR, nuk ka objekte në zbatim nga fondet e FZHR dhe nuk ka fatura të palikuiduara nga investimet e kryera me fondet e FZHR.

Mbi dokumentacionin mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Është rakorduar çdo muaj me degën e Thesarit Delvinë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Delvinë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2020, në tërësi.

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2020		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	94.164	89.303	94.8
2	Sigurime shoqërore 601	16.476	14.743	89.48
3	ShP. Operat 602+ F.Rezerv	45.533	36.366	79.86
4	Emergj. Civile	4.300	1931	44.9
5	K. Qarkut 604	348	348	100
6	Nd ekonom invalid 606	84.511	84.343	100
7	Mjete ne ruajtje 466	10.149	732	7.21
8	Investime 230-231	29.801	21.963	73.69
	Totali	285.282	249.729	87.53

Burimi: Bashkia Delvinë

1. Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Delvinë u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre.

Situata: Për vitin 2020, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 285,282 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 249,729 mijë lekë ose në masën 88 %, sipas artikujve: paga në masën 94%, sigurime në masën 89 %, shpenzime operative në masën 80 %, dhe investime në masën 73 %. Sipas burimeve të financimit për vitin 2020, nga transferta e pakushtëzuar (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 81,891 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 70,496 mijë lekë ose në masën 86 %. Nga këto investime nga 25,590 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 19,224 mijë lekë ose në masën 75 %, kjo për shkak se faturat për likuidim janë të muajit dhjetor 2020 që janë pasqyruar si detyrime të viti në mbylljen e pasqyrave financiare. Nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,047 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 45,301 mijë lekë ose në masën 47 %. Nga këto, Paga nga 25,662 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 17,297 mijë lekë ose në masën 65 %, Sigurime shoqërore nga 635 mijë lekë janë realizuar në vlerën 0 mijë lekë, shpenzime operative nga 44,009 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 24,445 mijë lekë ose në masën 48 % dhe investime nga 14,441 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 3,211 mijë lekë ose në masën 19 %, kjo për shkak i mosrealizimit të të ardhurave vjetore të cilat nga 81,163 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt për vlerën 38,509 mijë lekë, pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta. Po ashtu në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e palikuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2019 janë në

vlerën **63,211,952 lekë** ose 30% e buxhetit fillestarë. **Nga transferta e pakushtëzuar** sektoriale treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 60,924 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 51,103 mijë lekë ose në masën 84 %. Nga këto investime nga 1,000 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 0 mijë lekë kjo për shkak se nuk kanë kryer procedurë prokurimi. **Nga fondet e deleguara** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,017 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 86,498 mijë lekë ose në masën 99 %. Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitin 2020 të ketë mosrealizime kjo paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Vitet	Programimi dhe realizimi i të Ardhurave		Diferenca	Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet		Diferenca
	Plani	Fakti		Plani fillim Buxhetit	Fakti në thesar sipas realizimit dhe i trashëguar.	
Viti 2020	81,163	38,509	42,654	87,047	45,301	41,746

Burimi: *Bashkia Delvinë*

Sa më sipër, për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 81,163 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 38,509 mijë lekë ose 47 %, **me një mosrealizim në vlerën 42,654 mijë lekë**. Sipas planifikimit dhe realizimit në buxhet për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej nga 87,047 mijë lekë në buxhetin fillestar, janë çelur në thesar sipas realizimit faktik dhe ato të trashëguara në vlerën 45,301 mijë lekë ose 52 %, **me një mosrealizim në vlerën 41,746 mijë lekë**.

Numri i punonjësve dhe niveli i pagave për vitin 2020 është miratuar me VKB nr. 36, datë 23.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2015, datë 08.01.2020. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore si dhe numri i punonjësve plan fakt paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Vitet	Paga (600)		Sigurime (601)		Nr i punonjësve	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
2020	102,529	89,302	17,110	14,742	189	187

Miratimi i buxhetit faktik për vitin 2020 është bërë me VKB nr. 8, datë 01.03.2021.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ÷Për Vetëqeverisjen vendore, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ÷Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ÷Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendorë; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, ÷Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak

Efekt/Impakti: Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku:

Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve.

Rëndësia: E lartë.

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Delvinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave Bashkia Delvinë, të marrë masë në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

2. Titulli i gjetjes: *Në Bashkinë Delvinë u konstatua se në buxhetin e vitit 2020 nuk janë programuar si zë më vete likuidimi i detyrimeve për faturat të palikuiduara, nuk është ndjekur radha e likuidimit të tyre dhe ka raste kur ato nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë.*

Situata : Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2020 në janë për **vlerën 65,718,098 lekë** nga këto: *Llog (401-408) òFurnitor e llogari të lidhura me toò*, paraqiten në **vlerën 2,086,415 lekë** dhe detyrime të tjera në llog (467) òKreditorë të ndryshëmò, paraqitet në **vlerën 63,631,683 lekë**, sipas të dhënave ***Aneks nr. 1, nr. 2, bashkëlidhur Raport Auditimit:***

Nga të dhënat rezulton se deri me datë 30.09.2021 nga totali i faturave të palikuiduara në fund të viti 2020 për vlerën 65,718,098 lekë, janë likuiduar gjithsej për vlerën 6,111,046 lekë. Gjendja e faturave të palikuiduara me datë 30.09.2021 është gjithsej **për vlerën 59,607,052 lekë, nga këto: Llog (401-408) òFurnitor e llogari të lidhura me toò**, në **vlerën 1,750,298 lekë** dhe llog (467) òKreditorë të ndryshëmò, në **vlerën 57,856,754 lekë**. Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/ investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Delvinë, për periudhën 01.01.2020 ó 31.12.2020, u konstatua se nuk janë likuiduar 41 fatura në vlerën 13,264,298 lekë brenda afatit 30 ditore nga momenti i paraqitjes se tyre, dhe nuk janë likuiduar në 17 raste vlera e plotë e faturave sipas të dhënave ***Aneks nr. 3, nr. 4, bashkëlidhur Raport Auditimit:***

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimi i MF nr. 2 datë 06.02.2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò i ndryshuar, pikat 253,354, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 òPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò neni 40, 48 dhe Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101.

Efekti/Impakti: Nuk është respektuar radha e likuidimit të detyrimeve për faturat e periudhave të mëparshme me buxhetin e vitit pasardhës, nuk është bërë analizë nga titullari i institucionit si dhe nxjerrja e përgjegjesisë administrative për detyrimet e prapambetura.

Shkaku:

Nga mos realizimi i të ardhurave. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura dhe analizimin e të gjitha detyrimeve.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Delvinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa

likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

3. Titulli i gjetjes: *Mosrealizim i të ardhurave dhe mos ndjekjen e plotë e procedurave ligjore për realizimin e tyre. Për mbledhjen e detyrimeve debitorë.*

Situata: Në Bashkinë Delvinë, ka funksionuar Sektori i të Ardhurave të Taksave dhe Tarifave Vendore. Paketat fiskale për vitin 2020 është miratuar me VKB , Nr. 35, date 23.12.2019 òMbi miratimin paketës fiskale për vitin 2020, shprehur ligjshmëria nga Prefektura e Qarkut Vlore me shkresë nr. 2015/1, datë .8.01.2020. Gjatë vitit paketës fiskale i janë bërë ndryshime me VKB Nr 9 datë .24.02.2020, òMbi miratimin e disa ndryshimeve në paketën fiskale për vitin 2020. Bashkia Delvinë sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit për vitin 2020.

Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 81,163 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 38,509 mijë lekë ose 47%, **me një mosrealizim në vlerën 42,654 mijë lekë**, sipas të dhënave në **Aneks nr. 5**, bashkëlidhur Raport Auditimit. Me mosrealizim të dukshëm paraqiten :

-Taksa e tokës, nga 32,468 mijë lekë e parashikuar, është realizuar në vlerën 4,408 mijë lekë ose 14 %, me mosrealizim **në vlerën 28,060 mijë lekë**, ose 34% e planit të të ardhurave.

-Taksa mbi ndërtesat, nga 5,107 mijë lekë e parashikuar, është realizuar në vlerën 2,954 mijë lekë ose 58 %, me mosrealizim **në vlerën 2,153 mijë lekë**, ose 2.6% e planit të të ardhurave.

Nga të dhënat e Sektorit të të Ardhurave, për vitin 2020 të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore të cilat mblidhen me agjent tatimorë rezultojnë se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos pasur një regjistër të saktë për numrin e subjekteve të cilët e kalojnë xhiron vjetore dhe në zbatim të ligjit kanë paguar Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, për pasojë kjo taksë për vitin 2020 rezulton me tejkalim, taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një regjistër të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Delvinë e për pasojë në vitin 2020 rezulton me tejkalim.

Kriteri: Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, òPër vetëqeverisjen vendore, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendore i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, òPër taksat kombëtare, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

Efektiviteti/Impakti: Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku: Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Sektori i të Ardhurave në Bashkia Delvinë të marrë masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore. real i të ardhurave kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave të hartohet një plan real me analizë me qëllim mirë planifikimin dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore.

4. Titulli i gjetjes: Mos ndjekjen e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.

Situata: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 13,492 mijë lekë dhe me datë 31.12.2020 popullata për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën gjithsej prej 25,034 mijë lekë, **gjithsej në vlerën 38,526 mijë lekë**. Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Në 000/lekë

c	Emërtimi	2020	
		Vlera	Nr. Subjekte
	Debitorë ne total	13,492	236
	Biznesi i vogël	10,990	224
	Biznesi i madh	2,502	12

Burimi: Bashkia Delvinë

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël e biznesit të madh me datë 31.12.202, **për 236 subjekte në vlerën 13,492 mijë lekë** sipas të dhënave në **Aneks nr. 6, bashkëlidhur Raport Auditimit:**

Spektori i të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore, me ndryshime.

Për periudhën objekt auditimi rezulton se subjektet debitorë janë aktiv pra kryejnë biznes, konstatohet se ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Ndërsa **vlera prej 25,034 mijë lekë janë** debitorët 2767 familje për taksat e tarifat vendore me datë 31.12.2020, për mospagesën e detyrimeve për **taksë toke për 1743 familje për vlerën 22,776 mijë lekë** sipas pasqyrave si më poshtë:

Debitorët familjarë për taksë toke me datë 31.12.2020.

Lëvizjet debitorë	Taksë toke bujqësore	
	Numër familjesh	Vlerë
Gjendja me 31.12.2019	1630	19,655
Shtuar gjatë viti 2020	113	7,529
Pakësuar gjatë viti 2020		4,408
Gjendje me 31.12.2020	1743	22,776

Burimi: Bashkia Delvinë

Për mospagesën e detyrimeve për **taksë ndërtese dhe tarifa vendore për 1024 familje për vlerën 2,257 mijë lekë** sipas pasqyrave si më poshtë:

Debitorët familjarë për taksë ndërtese e tarifa vendore, me datë 31.12.2020.

Nr	Emërtimi	Nr/Fam	Debitorë
1	Delvine	662	1,800,140
2	Rusan	46	76,625
3	Vllahat	12	16,453
4	Bamatat	47	71,314
5	Stjar	84	101,640
6	Blerimas	14	41,161

Nr	Emërtimi	Nr/Fam	Debitorë
7	Bajkaj	109	91,905
8	Palavli	23	34,176
9	Kopacez	3	2,000
10	F.Verri	15	15,309
11	Vergo	9	6,802
	TOTALI	1024	2,257,525

Burimi: *Bashkia Delvinë*

Kriteri: Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, òPër vetëqeverisjen vendoreò, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, òPër taksat kombëtareò, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

Efektiviteti/Impakti: Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku: Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: *E lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Bashkia Delvinë, Sektori i të Ardhurave, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në R.SHò, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **38,526,012 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore Republikane e Shqipërisëò me ndryshime.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 òMospagimi taksave dhe tatimeveò.

Për problemet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

E. J. me detyrë Drejtor Finance për periudhën e auditimit.

A. F. me detyrë ish Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore për periudhën e auditimit.

III/2.2. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.

Për vitin 2020, në përputhje me kërkesat e Udhëzimi i MF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Delvinë me shkresën Nr. 433 prot., datë 19.02.2021.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, të pozicionit financiar Bashkia Delvinë; Formati nr.1, bashkëlidhur Projekt raportit të Auditimit.

Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë, është kryer nga komisionet të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë, konkretisht:

- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 3460 datë 24.12.2020 òPër ngritjen e grupit të inventarizimit të aktiveveò .

-Për aparatit e bashkisë, Kulturën dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve i përbërë nga tre anëtarë.

-Për shkollat e qytetit kopshtet dhe çerdhet me nga tre anëtarë.

-Për shkollat e fshatit dhe njësinë administrative Vergo me tre anëtarë.

-Për sektorin e PMNZSH me tre anëtarë.

-Për asetet me tre anëtarë.

Nga inventarizimi nuk kanë rezultuar diferenca dhe materiale jashtë përdorimit, fletët e inventarit janë të firmosura nga komisioni dhe personat përgjegjës.

Nga Drejtoria e financës është përgatitu përmbledhësja e inventarëve e cila është firmosur nga komisioni.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466, 85 dhe llogaritë e të Ardhurave. Viti, 2020.

Llogaritë kryesore të rakorduara me Degën e Thesarit Delvinë

- **llogaria 520** òDisponilitete në Thesar” , është në pasqyrat financiare për vlerën debitorë 35,034,622 lekë e përbërë nga llogaria 85 òRezultati I Veprimtarisë ushtrimoreò në vlerën 25,617,954 lekë dhe nga llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 9,416,668 lekë. Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit të datës 22.01.2021, është analizuar si me poshtë vijon:

I. Të trashëguara nga viti 2019.

Sipas akt rakordimit për vlerën.....	20,476,424 lekë
Grandi i trashëguar.....	8,396,818 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	2,794,323 lekë
Mjete në ruajtje të trashëguara.....	9,285,283 lekë

II. Të hyra (shesat debitorë) gjatë vitit 2020

Grandi i vitit.....	80,564,634 lekë
Të ardhurat e vitit.....	40,738,084 lekë
Të hyra nga mjete në ruajtje.....	86,692 lekë
Grandi sektorial.....	53,853,719 lekë
Këshilli i Qarkut Vlorë.....	1,768,765 lekë
Shuma e hyrjeve gjatë vitit ushtrimor.....	177,788,894 lekë
Totali i të ardhurave (Hyrjet debitorë) për vitin 2020 (I+II)=	20,476,424+177,788,894 =
198,265,318 lekë.	

III. Lëvizjet kreditore të llogarisë:

Mjete në ruajtje.....	732,307 lekë
-----------------------	--------------

Paga, Sig. Shoq.....	101,941,260 lekë
Shpenzime operative.....	38,245,666 lekë
Transferta Këshilli i Qarkut.....	348,043 lekë
Investime.....	21,963,420 lekë
Totali i shpenzimeve (lëvizjet kreditore).....	163,230,696 lekë
Gjendja kreditore (Saldo debitorë) në fund të vitit 2020, është (198,265,318 ó 163,230.696) = 35,034,622 lekë.	

Analiza mbi lëvizjen debitorë të kësaj llogarie në shumën totale 35,034,622 lekë, është si vijon:

I. Të trashëguara. Gjendja në fund të vitit 2020 paraqitet si me poshtë vijon:

Grand (p/kushtezuar+sektorial)i trashëguar.....	21,216,579 lekë
Të ardhura të trashëguara.....	4,401,375 lekë

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese për vitin 2019 paraqiten në vlerën 29,082,433 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2020 paraqitet në vlerën 29,305,318 lekë, më shumë për vlerën 222,885 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet për vitin 2019 paraqiten në vlerën 1,075,540 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2020 paraqitet në vlerën 721,141 lekë, vlerë e cila është e barabarta me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet për vitin 2019 paraqiten në vlerën 28,006,893 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2020 paraqitet në vlerën 28,584,177 lekë, vlerë e cila është e barabarta me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 99,721,202 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2019 në vlerën 84,352,178 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** paraqitet për vitin 2019 në vlerën 74,817,699 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2020 paraqitet në vlerën 76,557,191 lekë, me rritje në vlerën 1,739,492 lekë.

Në mënyrë analitike debitorët paraqiten në pasqyrën *Aneks 2/1 bashkëlidhur Projekt raportit të Auditimit.*

- **Gjendja e llogarisë 4342** òOperacione me shtetin (të drejta)òpër vitin 2020 paraqitet në shumën 23,164,011 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 òDetyrime ndaj personelitò për vlerën 6,546,178 lekë, llog.431 òDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò për vlerën 458,065 lekë, llog.435 òSigurime shoqëroreò për vlerën 1,966,994 lekë, llog.436 òSigurime shëndetësoreò për vlerën 265,980 lekë dhe faturat të mbërritura në dhjetor të vitit 2020 e të palikuiduara, në vlerën 13,926,794 lekë që i përkasin llogarisë 467 òKreditorë të ndryshëmò dhe llogarisë 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò.

I. Titulli i gjetjes: *Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërpartit 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 63,631,683 lekë.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 51,791,304 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 63,211,952 lekë. **Për vitin 2020** gjendja e llogarisë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò në aktiv **nuk rakordon** me gjendjen e llogarisë kundërpartit 467 òKreditorë të ndryshëmò dhe llogarisë 401-408 òFurnitor e llogari të lidhura me toò në pasiv të bilancit e

cila paraqitet për vlerën 65,718,098 lekë për faktin se diferenca për vlerën 13,926,794 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 *Operacione me shtetin* (të drejta)ö.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ö, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ö.

Impakti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku:

Mos zbatim i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ö, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ö.

Rëndësia: I Mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale për llogarinë 4342 *Operacione me shtetin*(*Te drejta*)ö, për vlerën 9,237,217 lekë dhe llogaria 486 *Shpenzime te periudhave te ardhshme*ö, për vlerën 65,718,098 lekë.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I *Investime*ö) në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 907,917,733 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 891,231,974 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b *Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ö në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 985,672,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 956,595,819 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** si në mbyllje të vitit 2020 dhe të vitit 2019 paraqitet në vlerën 0 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/a *Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ö paraqitet në mbyllje të vitit 2020 dhe 2019 me vlerë 0 lekë.

2.Titulli i gjetjes: *Aktivet Afatgjata Materiale mbi saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e vlerave të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2020.*

Situata: Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “**Aktivet afatgjata materiale**” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I *Investime*ö) në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 907,917,733 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 891,231,974 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b *Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*ö në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 985,672,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 956,595,819 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

-Llogaria 210 *Toka, troje, terrene*ö paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 dhe vitit 2019 në të njëjtën vlerë prej 52,081,640 lekë, është e analizuar në 4 objekte sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Vlera
1	Njësia Administrative Delvinë	51,936,640
	Varrezat publike	5,237,322
	Varrezat e qytetit	260,760
	Rrethimi i zyrave te Bashkisë	514,198
	Truall ish Brigada Këmbëorisë Delvine	4,591,1360
2	Njësia Administrative Vergo	158,000
	Shuma	52,081,640

Burimi: *Bashkia Delvinë*

Llogaria 211 *ËPyje, Kullota, Plantacione* paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 në shumën totale prej 4,500,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 4,500,000 lekë, është e analizuar për 1 objekte.

Llogaria 212 *ËNdërtime konstruksione* paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 187,668,241 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 186,037,893 lekë me një diferencë në rritje prej 1,630,348 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit të kryer për rritjen e AQT, është e analizuar në 30 objekte sipas pasqyrës Aneks 2.2 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Llogaria 213 *ËRrugë rrjete vepra ujore* paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 678,648,382 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 658,434,590 lekë me një diferencë në rritje prej 20,213,792 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit të kryer për rritjen e AQT, është e analizuar në 94 objekte sipas pasqyrës aneks bashkëlidhur.

Nga auditimi u konstatua se asnjë nga aktivitetet si më sipër nuk janë regjistruar në hipotekë, vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2020, përfaqësojnë vetëm investimet që janë bërë ndër vite nuk ka të dhëna lidhur me datën e krijimit të këtyre aktiveve sa ka qenë vlera e tyre në momentin kur kanë filluar shtesat për vlerën e investimeve të kryera. Nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* Kreu II *ËParimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* pika 5.

Veprimet e mësipërme, na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket zërave; 210 Toka, troje, terrene, 211 Pyje Plantacione, 212 Ndërtesa e Konstruksione, 213 Rruge, rrjete, vepra ujore dhe për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Impakti: Pamundësia në inventarizimin e tyre, saktësinë dhe përkatësinë e vlerave kontabël, me qëllim saktësinë e paraqitjes së tyre në Pasqyrat Financiare për vitin 2020.

Shkaku: Moszbatim i ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin*, neni 6 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Delvinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës dhe të marrin masa për krijimin dhe saktësimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përkatësisht për zërat; 210 *ËToka, troje terrene*, 211 *ËPyje, Kullota, Plantacione*, 212 *ËNdërtime e konstruksione*, 213 *ËRrugë, rrjete, vepra ujore* dhe regjistrimin e tyre në hipotekë.

Llogaria 214 *“Instalime teknike, makineri paisjen, vegla pune* paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 11,614,150 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 8,699,704 lekë, është e analizuar në 22 objekte sipas pasqyrës Aneks 2.2/1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Llogaria 215 *Ëmjetet transportive* paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 32,761,354 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 31,761,354 lekë me një diferencë në rritje prej 1,000,000 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit të kryer për blerjen e një mjeti, është e analizuar në 15 mjete sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr	E M E R T I M I	Vlefte
1	Makina e pastrimit (Jashtë Pune)	803,025
2	Makina e pastrimit (Jashtë Pune)	196,212
3	Autoveturë e administratës Benz Targa DI 3080 A	1,475,000
4	Makina tip "Xhip Hundaj" marka Galloper (Jashtë Pune)	1,480,000
5	Mjet Benc (Jashtë Pune)	800,000
6	Autoveturë tip "Ford" Targa AA 253 IU	698,600
7	Makina teknologjike e pastrimit Targa AA 178 NR	1,428,000
8	Automjeti "Stajer" PMNZSH	1,000,000
9	Automjeti "Marta Internacional" (Jashtë Pune)	700,000
10	Volsvagen PMNZSH	1,471,086
11	Xhip Lanrover (Jashtë Pune)	1,248,800
12	Xhip Foristradë (Jashtë Pune)	1,499,000
13	Skrepi Targa AI-MT 63	2,614,500
14	Skrepi I Bordit të Kullimit	16,347,131
15	Automjet tip DAMLER targa AA8821N	1,000,000
	Shuma	32,761,354

Burimi: *Bashkia Delvinë*

Llogaria 218 "*Inventar ekonomikë* në datën 31.12.2020 është në vlerën 5,707,578 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 6,283,808 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 18,398,952 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,080,638 lekë në rritje për vlerën 3,318,314 lekë, e cila përfaqëson shtesat e vitit për blerje të ndryshme.

3. Titulli i gjetjes: *Llogaria 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" nuk është paraqitur saktë për vlerën 39,960 lekë.*

Situata: *Gjendja e llog. 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 39,960 lekë dhe 2019 paraqitet në vlerën 39,960 lekë, kjo për blerje vegla dhe paisjen pune, që i përket llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri paisjen, vegla pune", kur në fakt nga testimi rezultoi se, këto paisjen janë bërë hyrje në magazinë pra kemi shtesë të kësaj llogarie pra nuk është investim në proces. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ò Aneksi 1, Klasa 23 në të cilën përcaktohet: "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:*

- Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve.

- Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, "Investime".

- Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, "Investime" ndahet në dy llogari tre shifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatë shifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.

- Llog.230, "Investime për aktive afatgjata jo materiale", të analizuar në llogari shtatë shifrore; dhe

- Llog. 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", të analizuar në llogari shtatë shifrore."

Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohet në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara."

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

Impakti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatim i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

Rëndësia: I Mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës Bashkia Delvinë, të marrë masa për sistemimet e llogarive me vlerat e tyre reale për llogarinë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" për vlerën 0 lekë dhe llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisjen, vegla punëò, për vlerën 5,775,840 lekë.

Gjendja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,086,415 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 2,690,891 lekë.

Gjendja e llogarisë 401-408 me 31.12.2020

Nr	E M E R T I M I	FATURA TATIMORE NUMER DHE DATE	SHUMA
1	N... shpk-Blerje materiale pesticide	Fatura tatimore nr. 154 dt 28.12.2018	77,118
2	V... shpk-Blerje materiale mirëmbajtje	Fatura tatimore nr. 194 ,195dt 18.04.2019	801,840
3	A...	Fatura tatimore nr. 10 ,dt 17.08.2020	526,400
4	M.N.	Fatura tatimore nr. 36 ,dt 09.06.2020	344,940
5	O.P.	Fatura tatimore nr. 02 ,dt18.11.2020	99,717
6	K...	Fatura tatimore nr. 206 ,dt 26.06.2020	236,400
	SHUMA		2,086,415

Burimi: Bashkia Delvinë

Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit" paraqitet në vlerën 6,546,178 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës.

Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat" paraqitet në vlerën kontabël 458,056 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit pasardhës.

Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore" paraqitet në vlerën 1,966,994 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

Gjendja e llogarisë 436 "Sigurime shëndetësore" paraqitet për vlerën kontabël 265,980 lekë.

Gjendja e llogarisë 466 òKreditorë për mjetet në ruajtjeò në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 9,285,283 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 9,416,668 lekë, pra ka një rritje prej 131,385 lekë. Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga: 5% fondi i garancisë për punime dhe shërbimet për kontrata të ndryshme me subjektet sipas pasqyrës aneks bashkëlidhur akt konstatimit.

Nga Bashkia Delvinë, nuk janë marrë veprimet e nevojshme për çongurtësimin e fondeve të cilave u ka kaluar afati i garancisë me qëllim përdorimin e tyre për interes publik.

Nga auditimi i kësaj llogarie për procedurat mbi ngurtësimin e 5% të vlerës së situacionit, u konstatua se në çdo rast të pagesave është ndalur vlera e garancisë.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 60,521,061 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 63,631,683 lekë, pra ka një rritje prej 3,380,622 lekë. Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore sipas pasqyrës Aneksi 2.3 bashkëlidhur akt-konstatimit.

III/2.3. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

3.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2020 ó 30.6.2021. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Delvinë". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB óve përkatëse, në përputhje me nenin 4 óRegjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publikó, pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në Vendim i KM nr. 914, neni 4, pika 3.

3.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Nga të dhënat e Drejtoria e Financës dhe auditimi i tyre, u konstatua se për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021 nga vlera e kontratave të lidhura prej 92,989 mijë lekë. Janë planifikuar për likuidim sipas periudhave dhe të miratuara në buxhet vlera 51,915 mijë lekë, ku është likuiduar vlera prej 36,089 mijë lekë, duke mbetur palikuiduara sipas periudhave përkatëse ushtrimore vlera **15,826 mijë lekë**, të dhëna të cilat paraqiten në tabelën nr. 1 më poshtë dhe detajuar në **Aneks 2.3.1** bashkëlidhur Raport Auditimit.

Tabela 1. Të dhënat mbi planifikim dhe likuidimin e kontratave, të shprehur në 000/lekë

Periudha ushtrimore	Vl. Kontratë lidhur	Planifikuar periudha	Likuiduar periudha	Pa likuiduar
Viti 2020	77,715,	39,238	33,955	5,282
Viti 2021 (6 mujori pare)	15,274,	12,676	2,133	10,543
TOTALI	92,989	51,915	36,089	15,826

Burimi: Nga të dhënat e Bashkisë Delvinë

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se Bashkia Delvinë planifikon procedura dhe pse nuk janë fondet në dispozicion, pasi megjithëse ka kontrata të palikuiduara nga periudha në periudhë, vijon me planifikimin e procedurave të reja pa një studim të mirëfilltë të fondeve në përdorim, **veprime të cilat në fund çojnë në rritjen e borxhit për faturat e palikuiduara.**

Gjithashtu konstatohet se jo e gjithë vlera e faturave të paraqitura për likuidim nga subjektet është likuiduar në vlerën e plotë të faturave të prera, *konkretisht të dhëna të paraqitura në tabelën 2.*

Tabela 2. Të dhënat mbi likuidimin e faturave të paraqitura, të shprehur në 000/lekë

Periudha ushtrimore	Fatura të prera	Vlera e paguar	Diferenca
Viti 2020	37,537	33,955	3,581
6/mujori I-rë/2021	6,302	2,133	4,169
TOTALI	43,839	36,089	7,750

Burimi: Nga të dhënat e Bashkisë Delvinë

Nga të dhënat e mësipërme tregohet situatën e vështirë financiare e kësaj bashkie në likuidimet e vlerës së faturave të paraqitura për likuidim dhe njëkohësisht rritjen e nivelit të detyrimeve kreditorë në fund të periudhave ushtrimore.

Burimi i financimeve sipas destinacionit paraqiten në tabelat nr. 3 dhe 4, si vijon:

Tabela nr. 3, Të dhënat mbi burimet e financimit viti 2020 shprehur në 000/lekë

Kontrata gjithsej te lidhura viti 2020	77,715
<i>Nga te cilat:</i>	
-Me financim nga te ardhurat e veta	5,628
-Me financim nga grandet	71,253
-Grande specifike	616
- Dhurata/Sponsorizime	0

Burimi: Nga të dhënat e Bashkisë Delvinë

Nga të dhënat e mësipërme për vitin 2020, konstatohet se nga vlera totale e fondeve të prokuruar prej 77,715 mijë lekë, janë planifikuar me grande të pakushtëzuara vlera 71,253 mijë lekë ose 91.6%, me transferta specifike vlera 616 mijë lekë ose 0.79% dhe me të ardhurat e veta vlera 209,890 mijë lekë ose 7.2%.

Tabela nr. 4, Të dhënat mbi burimet e financimit viti 2021 shprehur në 000/lekë

Kontrata gjithsej te lidhura viti 2021	15,274
<i>Nga te cilat:</i>	
-Me financim nga te ardhurat e veta	5,782
-Me financim nga grandet	3,609
-Grande specifike	5,882

Burimi: Nga të dhënat e Bashkisë Delvinë

Nga të dhënat e mësipërme për vitin 2021, konstatohet se nga vlera totale e fondeve të planifikuara prej 15,274 mijë lekë, janë planifikuar me grande të pakushtëzuara vlera 3,609 mijë lekë ose 23.6%, me transferta specifike vlera 5,882 mijë lekë ose 37.8% dhe me të ardhurat e veta.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{-së}, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan se:

Tabela nr. 5. Të dhënat mbi regjistrin e realizmit të procedurave periudha e vitit 2020, në 000/lekë.

EMËRTIMIT	Nr.	Fondi limit	Vlerë kontrate
Procedura gjithsej	25	67,661	64,829
Me vlerë të vogël	14	4,074	3,669
Me vlerë të lartë	11	63,586	61,159
Sipas natyrës	25	67,661	64,829
- Në fushën e ndërtimit	9	54,668	52,329
- Në blerje/shërbime	16	12,992	12,499

EMËRTIMIT	Nr.	Fondi limit	Vlerë kontrate
Sipas llojit të procedurës	11	63,586	61,159
- Të hapura	1	37,500	35,908
- Kërkesë propozim	10	26,086	25,251
Vlerësuar për auditim	4	48,716	46,800
- Të hapura	1	37,500	35,908
- Kërkesë propozim	3	11,216	10,891
- Shprehur në % të fondit	12	72	72.19

Burimi i të dhënave: Bashkia Delvinë

Tabela nr. 6. Të dhënat mbi regjistrin e realizimit të procedurave periudha e vitit 2021, në 000/lekë

EMËRTIMI	Nr.	Fondi limit	Vl. Kontrate
Procedura gjithsej	16	15,343	12,391
Me vlerë të vogël	3	11,064	9,228
Me vlerë të lartë	13	4,279	3,163
Sipas natyrës	13	15,343	12,391
- Në fushën e ndërtimit	3	6,930	5,319
- Në blerje/shërbime	10	8,412	7,072
Sipas llojit të procedurës	3	11,064	9,228
- Të hapura	1	6,176	4,610
- Kërkesë propozim	2	4,887	4,618
Vlerësuar për auditim	2	9,814	8,080
- Të hapura	1	6,176	4,610
- Kërkesë propozim	1	3,637	3,470
- Shprehur në % të fondit	6.25	63.96	65.20

Burimi i të dhënave: Bashkia Delvinë

1. Titulli i gjetjes. Mos argumenti i fondit limit për blerje karburanti.

Situata: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerje karburanti për periudhën 01.01.2020 ó 31.12.2020, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, pasi:

Vlera e karburantit e përlllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë gjendje në magazinë, analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (motogjenerator, kaldaja, etj) në qarkullim, sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, etj. Për sa i përket vlerës së përlllogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përlllogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar.

Kriteri: Veprime në kundërshtim me neni 1 *Objekti dhe qëllimi* pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik* i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga Vendim i KM nr. 914, datë 27.12.2014 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar, Kreu II *Rregullat e Përgjithshme të prokurimit* neni 9 *Llogaritja e vlerës së kontratës* (Trajtuar më hollësisht në pikën II/2.4.4 faqet 50 - 79 të Projektraport të Auditimit).

Ndikimi/Efekt: Mos përcaktimi i saktë i sasisë së karburantit sipas nevojave të Bashkisë Delvinë, janë veprime në keq menaxhim të fondeve për blerjen e këtij malli, pasi kërkohet sasi të paargumentuara.

Shkaku:

Mos zbatimi i legjislacionit nga strukturat përgjegjëse

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

2. Titulli i gjetjes: Në zbatimin e procedurave të prokurimit të periudhës 01.01.2020 – 30.6.2021, u konstatuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si në aplikimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Hapura	1	37,500	35,908	1,592	4.25
Kërkesë me propozim	13	37,151	34,480	2,671	7.19
SHUMA	14	74,651	70,388	4,263	5.7
Vlerësuara per auditim	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndaje total lloje	
				Fond limit	Kontratës
Hapura	1	37,500	35,908	100	100
Kërkesë me propozim	6	26,129	25,805	70.3	69.5
SHUMA	7	63,629	61,713	85	87.68

Burimi i të dhënave: Bashkia Delvinë

Situata: Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën sipër, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, u konstatua se janë realizuar gjithsej **14** procedura me fond limit 74,717 mijë lekë dhe vlerë kontrate 70,388 mijë lekë ose me një ulje prej 5.7%.

Grupi i KLSH^{se}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit nga 12 procedura me fond limit 74,717 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **7** procedura me fond limit 63,629 mijë lekë ose 85% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i **7** procedura me fond limit 63,629 mijë lekë, janë konstatuara në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **4** procedura me fond limit 49,717 mijë lekë (të dhëna të paraqitura në pasqyrën Aneks 4.1 të Raport Auditimit), shkelje të cilat kanë konsistuar në këto mangësi:

c- Në **2 raste**, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kriteret jo sipas llojit të procedurës dhe të paargumentuara

d- Në **3 raste**, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, ku procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorim me efektiv të fondeve publike në vlerën **39,585 mijë lekë** pa TVSH, nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procedurë.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

- Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, ku thuhet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

- **Neni 24**, “Anulimi i një procedure”, ku theksohet se:

1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;

b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;

c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;

ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;

d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;

dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji

- **Neni 46**, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku është përcaktuar se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:...”

- **Neni 47**, ðS`kualifikimi i ofertuesve, ku është përcaktuar se:

“Autoriteti kontraktor s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. Autoriteti kontraktor për çdo s`kualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

- **Neni 53**, “Shqyrtimi i ofertave”, ku është përcaktuar se:

“1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”.

- **Neni 55**, “Kriteret e përcaktimit të ofertës”, ku thuhet se:

2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.

- **Neni 58**, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, ku është përcaktuar se:

“1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji”.

a- **Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014**, ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, nenet:

- **Neni 26**, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 5, ku është përcaktuar se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

- **Neni 66**, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, ku është përcaktuar se:

“1. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

- **Neni 67**, “Klasifikimi i ofertave”, ku është përcaktuar se:

“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”.

- **Neni 69**, “Njoftimi i fituesit”, ku është përcaktuar se:

“Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinën e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP”.

- **Neni 70** “Lidhja e kontratës”, ku është përcaktuar se:

“Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktorë.

- **Neni 78** “Ankesat në autoritetin kontraktor, ku është përcaktuar se:

3. Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

a- Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës³ për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushë. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

Ndikimi/Efekt: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike për vlerën 42,884 lekë pa TVSH, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave trajtuar në vijim për periudhën Janar 2017 ó Dhjetor 2020.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë zbatues në fuqi, në aplikimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me mangësi.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Delvinë, të analizojë shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, për aplikimin e kriterëve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara dhe të shpalljes fitues të OE me kriterë të paplotësuar, duke mos vlerësuar drejt çdo dokument në përmbushje të kriterëve të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, kjo për të bërë të mundur përdorimin më efektiv të fondeve të prokuruar.

➤ **Mbi procedurat e prokurimit të audituara në periudhën 01.01.2020 – 30.6.2021**

1- Procedura e prokurimit me objekt “**Shtresë asfalti i rrugës “Fushë Vërri - Kalasë” dhe i rrugës “Blerimas - Finiq”**”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt “Shtresë asfalti i rrugës “Fushë Vërri - Kalasë” dhe i rrugës “Blerimas - Finiq”ö.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 3335, datë 10.12.2020	3. Njësia e Prokurimit M. B. A. T. A. D. O. R. K. M.	4. Komisioni VO nr. 3335/1, datë 10.12.2020 B. M. A. Th. K. T. G. L.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Hapurö,		

³ Shtuar me vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

		P. B.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 37,500,000 lekë REF-82616-12-18-2020 Financimi: Viti 2020 në shumën 4,166,666 lekë Viti 2021 në shumën 16,666,666 lekë Viti 2022 në shumë 16,666,666 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) òA....ò sh.a. me vlerën e ofertës 35,908,460 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1.592 mijë lekë pa TVSh ose 4.2 %
8. Data e hapjes së tenderit 27.01.2021	9. Burimi Financimit Bashkia Delvine/grande.	10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 2 OE: <i>Skualifikuar 1 OE</i> <i>Kualifikuar 1 OE</i>
11. Ankimime AK-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 441, Datë 2.02.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 35,908,460 lekë me afat 60 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

- Vlerësimi i kritereve:

Nga auditimi konstatohet se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, si dhe nuk janë marrë në konsideratë me gjithë rekomandimet e APP, si më poshtë:

Në DST në pikën 2.3.3-Për të provuar se ka përvojën e duhur, operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 40 (dyzet) punonjës, për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020).....

Nga dokumentacionit nuk tregohet arsyeja e këtij numri punonjësish, pasi nuk është paraqitur asnjë analizë pse kërkohet ky numër punonjësish, kjo në referencë të dispozitave të VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar.

Në DST në pikën pika 2.3.4. Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin si: ***Inxhinier Mjedisi 1 (një), Artitekt Pjesëzash 1 (një).***

Secili prej pjesëtareve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë në **Listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020)** dhe në **licensën e shoqërisë.**

Kërkesa për ing. Gjeolog, Mjedisi dhe Artitekt është e paargumentuar me zërat e preventivit dhe jo në zbatim të pikës 1 të nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014.

Kërkesa për disponimin të punonjësve dhe stafit i shërben AK për të provuar kapacitete teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohet të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Pra nuk janë mirë argumentuar kërkesa për këto inxhinier.

Në DT është kërkuar: 1 (një) inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 òPër sigurinë dhe shëndetin ne puneò dhe Vendim i KM nr. 312, date 05.05.2010 òPër miratimin e rregullores òPër sigurinë në kantierò, i cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë tre muajve të fundit.

Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër Sigurinë dhe Shëndetin në Punëò, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e autoritetit kontraktor që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e

ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i ndryshuar.

Nuk është mirë argumentuar kërkesa që inxhinieri të jetë i pajisur me certifikatë të sigurisë dhe shëndetit në punë, pasi referuar dispozitave të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 òPër sigurinë në punë⁴, i ndryshuar, dhe për rrjedhojë vlerësojmë se nuk është detyruesisht që inxhinieri të ketë këtë certifikatë të kërkuar nga AK, por mjafton një punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në DST është kërkuar: Specialist/ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontratë pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.

Kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publik, të ndryshuar.

Në DST pika 2.3.5 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponoj kontratë bashkëpunimi me një laborator të akredituar në fushën e testeve të materialeve të ndërtimit në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 e vërtetuar kjo me certifikatat e akreditimit nga organizma akreditues.

Kërkesa për një kriter të tillë nuk është e mirë argumentuar, pasi është detyrim ligjorë që OE të paraqesin mostrat dhe materialet në përputhje me ligjin e ndërtimit dhe të shoqëruar me certifikatat përkatëse dhe nuk ka pse të jetë kushte që duhet të ketë kontratë bashkëpunimi.

Në DST është kërkuar: Që OE pjesëmarrës të autobot naftë.

Është i paargumentuar kërkesa për një autobot naftë, pasi nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi nuk kemi të bëjmë me një procedurë blerje karburanti.

Konkluzioni:

Për mangësitë e konstatuara më sipër në aplikimin e kriterëve në kundërshtim me nenet 20 dhe 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òpër prokurimin publik, i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 27 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, veprime të cilat kanë çuar në mos pjesëmarrjen OE në procedura, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT:**

M. B., me detyrë shef kabineti

A. T., me detyrë juriste Bashkia Delvinë

A. D., me detyrë specialiste finance

O. R., me detyrë specialist transporti

K. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të PZHT

-Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SPE të APP, u konstatua se KVO nuk ka vlerësuar drejtë dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria òA....ò, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

⁴ Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, është profesionit i marrë në punë nga punëdhënëse dhe i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë në punë..

- a- Njëri nga mjetet me destinacion ÷Autobot ujë me targë AA...HB nuk paraqet **foto përkatëse**, siç kërkohet në DST.
- b- Shoqëria nuk ka deklaruar të saktë punimet në proces, pasi sipas buletinit të APP, shoqëria ka punime me ÷Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeo sha, **Bashkia Lushnje** për procedurë me nr. REF-... dhe objekt ÷ *Ndërtim ujësjetës të fshatrave Staukarnunar dhe Kashtë e Bardhë, bashkia Lushnje*, ku kjo shoqëri është shpallur fitues në vlerën 115,541,279 lekë.
- Shoqëria ka kontratë me **Bashkinë Patos** për tenderin me nr. REF -..... dhe objekt *÷Rikonstruksion i Magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës të qytetit Patos, loti II-tëoö*, ku fitues është shpallur shoqëria ÷A....io me ofertë 705,415,837 lekë pa TVSH.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër procedura nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë të sipërcituar në fillim të kapitullit II/2.3, pasi OE i vetëm i mbetur në garë nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhet ti propozonte autoritetit kontraktor anulimin e procedurës, duke argumentuar shkaqe dhe zhvillimin e një procedurë të re me kriteret më të favorshme, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve dhe për të siguruar një efektivitet të fondit të prokuruar në vlerën 37,500,000 lekë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: **B. M.**, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, **A. Th.**, me detyrë specialist I SPZHT, **K. T.** me detyrë ish- specialist në SPZHT, **G. L.**, me detyrë Drejtor i Njësisë së Shërbimeve dhe **P. B.** me detyrë Përgjegjës i IMTV.

- 2- Procedura me objekt **“Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e Bashkisë Delvinë”**, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt <i>“Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e Bashkisë Delvinë”</i> ÷.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 2315, datë 11.9.2020	3. Njësia e Prokurimit M. B. A. T. O. R.	4. Komisioni VO nr. 2316, dt. 11.9.2020 B. M. K. T. G. L.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit <i>“kërkesë me propozim”</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) ÷BASHKIM OE ÷E.....ö dhe ÷C....ö sh.a. me vlerën e ofertës 3,231,280 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 68 mijë lekë pa TVSh ose 2%
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,299,327 lekë REF-71952-09-16-2020	9. Burimi Financimit Bashkia Delvine/grande.	10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 3 OE: Skualifikuar 2 OE Kualifikuar 1 OE
8. Data e hapjes së tenderit 01.10.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
11. Ankimime AK-ka;	b. Kontrata	
14. Lidhja e kontratës Nr. 3087, Datë 11.11.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 3.299.327 lekë me afat 35 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

- Vlerësimi i procedurës:

Me nr. 2799, datë 22.10.2020 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Administratori **M. Q.** mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*, neni 68 dhe 69, si më poshtë:

Nga të dhënat, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë **3** ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkim OE ðE.....ö shpk me NIPT J...P dhe ðC....ö shpk me NIPT J...K me vlerë 3,231,280 lekë pa TVSH.
2. OE ðJ.....ö shpk me NIPT J...M me ofertë 2,988,170 lekë pa TVSH.
3. Bashkim OE ðT.....ö shpk me NIPT K...L & ð6.....ö shpk me NIPT L....H, me vlerë 2,600,880 lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. J.....ö shpk me NIPT J...M
2. Bashkim OE: ðT.....ö shpk me NIPT K...L & ð6.....ö shpk me NIPT L....H.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vlerësimin e KVO për skualifikimin e 2 operatorëve të mësipërme, konstatojmë se vlerësimi është në përputhje me dispozitat e LPP, trajtuar gjerësisht në faqen 26-47 të Projektraport Auditimit.

Ankesa: ka ose jo (PO)

Nga Bashkimi i OE ðT.... + 6D....ö me shkresën datë 17.10.2021 (sipas shtojcës 21), ka paraqitur ankesë për skualifikim të padrejtë nga KVO, *prot bashkia Delvinë nr. 2737, datë 19.10.2020.*

Me urdhër nr. 2738, datë 19.10.2020 të titullarit të AK është bërë pezullimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës së Bashkim OE ðT.... + 6D....ö.

Me urdhër nr. 2762, datë 20.10.2020 është ngritur KSHA me përbërje: *A. Th. me detyrë specialist I PZHT, B. K. me detyrë specialist jurist dhe A. D. me detyrë specialist finance.*

Nga KSHA me shkresën nr. 2737, datë 21.10.2020 është bërë analizimi i ankesës duke mos e marrë në konsideratë ankesën.

Me vendim nr. 2762/2, datë 21.10.2020 të titullarit të AK është vendosur sipas relatimit të KSHA për refuzim të ankesës së Bashkim OE ðT.... + 6D....ö si e pabazuar.

Me shkresën nr. 2762/1, datë 21.10.2020 është kthyer përgjigje Bashkim OE ðT.... + 6D....ö për mos marrje në konsideratë të ankesës.

Me vendim nr. 2799/1, datë 22.10.2020 është bërë miratimi i procedurës, duke shpallur fitues Bashkim OE ðE.....ö dhe ðC....ö shpk me vlerën 3,231,280 lekë me TVSh

Nga auditimi i dokumentacionit të Bashkim OE ðE.....ö dhe ðC....ö shpk të shpallur fitues nga KVO në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

- a- Nga shoqëria ðC....ö nuk paraqitet liçensa profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, duhet të jenë të kategorive:

- Kat.NP-1 A (Punime gërmimi ne toke);
- Kat.NP-4 A (Rruge, autostrada, mbikalime);
- Kat.NP-12 A (Punime te inxhinierisë se mjedisit);
- Kat.NS-18 A (Punime topogjeodezi);
- **Kat. NS-8/A (Ndërtime parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri)**

Gjithashtu dhe shoqëria ðE.....ö e cila 70.5% të punimeve nuk plotëson të gjitha pikat licencave, konkretisht kategoritë NP-12/4, NS-18/S dhe **NS-8/A**;

Konkluzioni: Nga sa trajtuam procedura është e parregullt në vlerësimin e OE fitues, pasi JV ðE.....ö dhe ðC....ö është shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriteve të DST të miratuara nga AK siç janë trajtuar më sipër . Veprimet e mësipërme kanë çuar keq menaxhim të fondeve publike **në vlerën 3,299,327 lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO:

B. M., me detyrë zv/kryetar Bashkie në cilësinë e kryetarit të KVO.
K. T., me detyrë ish- specialist në SPZHT.
G. L. me detyrë drejtor i Njësisë së Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresë nr. 2670/23, datë 14.12.2021 (prot KLSH nr. 1110/4, datë 16.12.2021) òMbi Projekt Raport Auditiminò, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

a- Për sa konstatoni se nga shoqëria “E...” nuk janë paraqitur pasqyrat financiare të certifikuara, sqarojmë se referuar ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditivin ligjorë, organizimin e profesionit të audituesit ligjorë dhe të kontabilistit të miratuar”, neni 41- Personat juridik që detyrohen për auditivin ligjorë të pasqyrave financiare, pika (c), subjekti nuk plotëson këto kushte. Nisur nga ky fakt, duke qenë se shoqëria nuk plotëson dy nga kushtet, nga KVO është marrë i mirëqenë bilanci i paraqitur pa certifikim.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Për sa kundërshtoni, argumenti i paraqitur nga subjekti qëndron dhe merret në konsideratë, kjo ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 òPër auditivin ligjorë, organizimin e profesionit të audituesit ligjorë dhe të kontabilistit të miratuarò, neni 41.

Për mangësitë e tjera nuk është paraqitur kundërshti. Procedura mbetet me probleme në vlerësim.

3- Procedura me objekt “*Blerje materiale ndërtimi, elektrike, hidraulike e tjera për mirëmbajtje rrugës, rrjete dhe kanale kullues*”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës me objekt “ <i>Blerje materiale ndërtimi, elektrike, hidraulike e tjera për mirëmbajtje rrugës, rrjete dhe kanale kullues</i> ”ò.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 2076, datë 19.8.2020	3. Njësia e Prokurimit M. B. O. R. B. K.	4. Komisioni VO me nr. 1328/2, dt. 29.5.2020 B. M. K. T. G. L.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë me propozimò,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,085,000 lekë REF-59392-05-29-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) òA.....ò sh.a. me vlerën e ofertës 1,996,700 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 89 mijë lekë pa TVSh ose 4.2 %
8. Data e hapjes së tenderit 22.6.2020	9. Burimi Financimit Bashkia Delvine.	10. Operatorë Ekonomike pjesëmarrës 5 OE: Skualifikuar 2 OE Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime AK-ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1867, Datë 22.7.2020	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 1,996,700 lekë me afat 30 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me datë 6.3.2020 në elektronik, APP ka kërkuar autoriteti kontraktor Bashkia Delvinë për ndërhyrjen në disa prej kritereve të aplikuara pasi nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP.

Me urdhër nr. 1388, datë 04.06.2020 titullari i AK ka vendosur pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e vërejtjeve të APP . Me PV datë 04.06.2020 njësia e prokurimit ka bërë

ndryshimin e disa prej kriterëve sipas orientimeve të APP, duke shtyrë hapjen e procedurës nga data 15.6.2020 për datën 22.6.2020.

Konkluzioni:

Në orientimet e dhëna nga APP, nga njësia e prokurimit nuk është marrë në konsideratë ndarja e procedurës në lote, pasi sipas objektit të prokurimit kemi të bëjmë me blerje materiale elektrike dhe materiale ndërtimi, pasi nuk janë mallra të të njëjtës natyrë, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë, veprime në kundërshtim me pikën 5 të nenit 9 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, për të cilën ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJHDT :

M. B. me detyrë shef kabineti (ekonomist)

B. K. me detyrë jurist i bashkisë

O. R. me detyrë specialist transporti

- Zhvillimi i procedurës:

Me nr. 1728, datë 09.07.2020 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit dhe i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. Q. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 68 dhe 69, si më poshtë:*

Kanë qenë 5 OE pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “N....” SHPK me Nipti J....S dhe ofertë 1,722,810 lekë pa TVSh.
2. Shoqëria “A.....” SHPK me Nipti L....Q dhe ofertë 1,996,700 lekë pa TVSh.
3. Subjekti fizik “A. G.” me Nipti K....U dhe ofertë 1,939,860 lekë pa TVSh.
4. Subjekti fizik “E. L.” me Nipti K....Q me ofertë 1,480,000 lekë pa TVSh.
5. Shoqëria “L....” SHPK me Nipti L....M me ofertë 2,050,000 lekë pa TVSh.

KVO-ja pas vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga 5 OE janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 3 OE, konkretisht:

Janë skualifikuar:

1. Subjekti fizik òA. G.ò me ofertë 1,939,860 lekë pa TVSh, pasi:
2. Subjekti fizik òE. L.ò me ofertë 1,480,000 lekë pa TVSh, pasi:
3. Shoqëria òN....ò SHPK me ofertë 1,722,810 lekë pa TVSh pasi:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vlerësimin e KVO për skualifikimin e 2 operatorëve të mësipërme, konstatojmë se vlerësimi është në përputhje me dispozitat e LPP, trajtuar gjerësisht në faqen 26-47 të Projektraport Auditimit.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjekti dhe sistemin SPE të APP, u konstatua se shoqëria òA.....ò plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK.

Në lidhje me OE të skualifikuar nga auditimi u konstatua se kualifikimi është në përputhje me kuadrin ligjorë të LPP.

4- Procedura me objekt **“Blerje Karburant, viti 2020”**

Procedura me objekt “Blerje Karburant, viti 2020		
1. Urdhër Prokurimi nr. 464/12.02.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 5/20.01.2019 M. B. O. R. B. K.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 464/1, dt. 12.02.2020 B. M. K. T. G. L.
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimë		

Procedura me objekt "Blerje Karburant, viti 2020ë		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 6,833,334 lekë pa TVSh REF -50718-02-17-2020	6. Oferta fituese (pa TVSH) EO òK...ò SHPK për vlerën 6,833,334 lekë pa TVSh me kontratë nr. 781 dt. 19.3.2020, me afat deri më 31.12.2020.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 6,833,334 lekë me marxhë fitimi 8.6% nafta dhe 13.1% benzina
8. Data e hapjes së tenderit Datë 2.3.2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. OE Pjesëmarrës në tender 1 OE/BASHKIM OE a) Skualifikuar 0 OE/BASHKIM OE b) Kualifikuar 1 OE

Hartimi fondit limit:

Me urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.01.2020 të titullarit të AK është ngritur njësia e prokurimit për hartimin e fondit limit, referuar kërkesave të njëjësive të Bashkisë Delvinë, konkretisht:

- a- Njësia e Shërbimeve Komunitare në vlerën 1,700,000 lekë;
- b- Sektori i Ujitjes-Kulimit në vlerën 6,000,000 lekë;
- c- Shërbimet e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri.

Vlera e karburantit e përlogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë , gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj*) në qarkullim e gjendje pune inventar i bashkisë Delvinë, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit. Përsa i përket vlerës së përlogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përlogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar. Në këto kushte veprimet në lidhje me përlogaritjen dhe argumentimin e vlerës limit të njoftimit të kontratës lidhen direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 òObjekti dhe qëllimiò pika 2, geramat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga Vendim i KM nr. 914, datë 27.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, Kreu II òRregullat e Përgjithshme të prokurimitò neni 9 òLlogaritja e vlerës së kontratësò, **për këtë ngarkohet me përgjegjësi NJP, respektivisht:**

1. **M. B.**, me detyrë Shef Kabineti;
2. **O. R.**, me detyrë Specialist transporti;
3. **B. K.** me detyrë specialist jurist.

V. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, për vitin 2020, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 285,282 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 249,729 mijë lekë ose në masën 88 %, **nga transferta e pakushtëzuar** (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 81,891 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 70,496 mijë lekë ose në masën 86 % dhe **nga të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e vitit**, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 87,047 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 45,301 mijë lekë ose në masën 47 %. Nga këto, paga nga 25,662 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 17,297 mijë lekë ose në masën 65 %, shpenzime operative nga 44,009

mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 24,445 mijë lekë ose në masën 48 % dhe investime nga 14,441 mijë lekë planifikuar janë realizuar në vlerën 3,211 mijë lekë ose në masën 19 %, kjo për shkak i mosrealizimit të të ardhurave vjetore të cilat nga 81,163 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt për vlerën 38,509 mijë lekë, pra planifikimi i shpenzimeve buxhetore nuk është real dhe i mbështetur në burime të sakta financimi për të ardhurat e veta. Po ashtu në planifikimin e shpenzimeve nuk janë marrë në konsideratë faturat e palikuiduara të vitit paraardhës që për vitin 2019 janë në vlerën **63,211,952 lekë** ose 30% e buxhetit fillestarë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër Vetëqeverisjen vendore, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, òPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 òPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Delvinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e të Ardhurave, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e bilancit, konstatohet se totali i faturave të palikuiduara në fund të vitit 2020 janë për **vlerën 65,718,098 lekë** nga këto: *Llog (401-408) òFurnitor e llogari të lidhura me toò*, paraqiten në vlerën 2,086,415 lekë dhe detyrime të tjera në llog (467) òKreditorë të ndryshëmò, paraqitet në vlerën 63,631,683 lekë, nga të dhënat rezulton se deri me datë 30.09.2021 nga totali i tyre janë likuiduar gjithsej për vlerën 6,111,046 lekë, mbetet për likuidim **vlera 59,607,052 lekë**, arsyeja e mos likuidimit të këtyre faturave është nga mos realizimi i të ardhurave. Gjithashtu u konstatua se nuk janë likuiduar 41 fatura në vlerën 13,264,298 lekë brenda afatit 30 ditore nga momenti i paraqitjes së tyre, dhe nuk janë likuiduar në 17 raste vlera e plotë e faturave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë nënenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimi i MF nr. 2 datë 06.02.2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò i ndryshuar, pikat 253,354, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 òPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò neni 40, 48 dhe Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Delvinë, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite për vlerën **59,607,052 lekë** dhe të hartojë një grafik likuidimesh, duke zbatuar radhën e pagesave.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 edhe pse ka dalë urdhri për inventarizimin e aktiveve për, llogaritë 210 òToka, troje, terreneò, 211 òPyje Plantacioneò, 212 òNdërtesa e Konstruksioneò, 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò, asnjë nga

aktivet nuk janë regjistruar në ASHK Sarandë, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo Kreu II për parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për hartimin dhe krijimin e regjistrit e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përkatësisht për zërat; 210 òToka, troje terreneo, 211 òPyje, Kullota, Plantacioneo, 212 òNdërtime e konstruksioneo, 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreo dhe regjistrimin e tyre në hipotekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u konstatua se:
a- Gjendja e llogarisë 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeo në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 òKreditorë të ndryshëmoo dhe llogarisë 401-408 òFurnitor e llogari të lidhura me too në pasiv të bilancit e cila paraqitet për vlerën 65,718,098 lekë për faktin se diferenca për vlerën 13,926,794 lekë është pasqyruar në aktiv në llogarinë 4342 òOperacione me shtetin (të drejta)ò.

b- Llogaria 231 òShpenzime në proces për rritjen e AQTò në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 39,960 lekë. Kjo vlere përfaqëson blerjen e veglave dhe pajisjeve pune, te cilat duhet te regjistroheshin ne llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla puneo sepse, pajisjet jane blere dhe jane likuiduar në vlerën e plote te tyre, dhe jane bere hyrje ne magazine, pra nuk konsiderohen investime ne proces, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareo dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo Kreu II për parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo pika 5 dhe Aneksi 1, Klasa 23 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.2, faqe 26-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi:

Drejtoria e Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive me vlerat e tyre reale për:

Llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” për vlerën 0 lekë dhe llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla puneo, për vlerën 5,775,840 lekë.

Llogarinë 4342 òOperacione me shtetin(Te drejta)”, për vlerën 9,237,217 lekë dhe llogarinë 486 òShpenzime te periudhave te ardhshmeo, për vlerën 65,718,098 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blere karburanti për periudhën 01.01.2020 ó 30.6.2021, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, pasi:

Vlera e karburantit e përlogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë gjendje në magazinë, analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj*) në qarkullim, sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, etj. Përsa i përket vlerës së përlogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përlogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar, në kundërshtim me nenin 1 *Objekti dhe qëllimi* pika 2, germa (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik* i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga Vendim i KM nr. 914, datë 27.12.2014 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar, Kreu II *Rregullat e Përgjithshme të prokurimit* neni 9 *Llogaritja e vlerës së kontratës* (Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqet 40-46 të Projektraport të Auditimit).

5.1 Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Delvinë të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Delvinë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Kavajë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2020 ó 30.6.2021, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 *Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të procedurave, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, janë realizuar gjithsej **14** procedura me fond limit 74,717 mijë lekë dhe vlerë kontrate 70,388 mijë lekë ose me një ulje prej 5.7%.

Grupi i KLSH-^{se}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit nga 12 procedura me fond limit 74,717 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **7** procedura me fond limit 63,629 mijë lekë ose 85% të fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 7 procedurave me fond limit 63,629 mijë lekë, ne **4** prej tyre me fond limit 49,717 mijë lekë janë konstatuar shkelje të rregullave të prokurimit publik, (*të dhëna të paraqitura në pasqyrën Aneks 4.1 të Raport Auditimit*), të cilat konsistojnë:

e- Në **2 raste**, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, pasi janë aplikuar kriteret jo sipas llojit të procedurës dhe të paargumentuara

f- Në **3 raste**, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, ku procedurat duheshin anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte më të favorshme për të siguruar përdorim me efektiv të fondeve publike në vlerën

42,884 mijë lekë pa TVSH, që do të vinte nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procedurë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 24, “Anulimi i një procedure”, neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 47, “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës”, neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 26, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 5, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit”, neni 70 “Lidhja e kontratës”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor, si dhe rekomandimeve të APP (Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 32-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Delvinë, të analizojë shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, për aplikimin e kriterëve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara dhe të shpalljes fitues të OE me kriterë të paplotësuar, duke mos vlerësuar drejt çdo dokument në përmbushje të kriterëve të miratuara në DST, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve të prokura me vlerë 42,884 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i të Ardhurave Bashkia Delvinë, konstatohet se, në fund të periudhës janë gjithsej debitorë **236** subjekte në vlerën **13,492,487 lekë** dhe **2767** familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerë **25,033,525 lekë**.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI *“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008* *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1, faqe 20-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi:

Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Delvinë, bazuar në nenin 70 pika 3 *“drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008* *“Për Procedurat tatimore në R.SHö, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 38,526,012 lekë, si më poshtë vijon:*

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.*

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë me ndryshime.*

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 *ëmospagimi taksave dhe tatimeve*.*

Brenda datës 30.3.2022

E. MASA DISIPLINORE

E/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *oPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjerat (b, c, ç) e nenin 58-*oLlojet e masave disiplinore*, të ligjit nr. 152/2013 *oPër nëpunësin civil, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 oPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil dhe shkronja (k) e neni 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 oPër vetëqeverisjen vendore, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë që t*aj* kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSHóse, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga *oVërejtje* deri në *oLargim nga puna* për **6 (gjashtë) punonjës**, si më poshtë:**

1- **E. J.** me detyrë drejtor Finance për periudhën e auditimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në lidhje me mos likuidimin e faturave sipas radhës së pagesave dhe krijimin e detyrimeve të faturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore, duke rritur vështirësinë financiare të Bashkisë Delvinë, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, Udhëzimi i MF nr. 2 datë 06.02.2012 *oPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit* i ndryshuar, pikat 253,354, Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 *oPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 *oPër financat e Vetëqeverisjes Vendore* neni 40, 48 dhe Udhëzimi i MF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit" neni 101 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.1 dhe 2.3 faqe 17-26 dhe 32-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2- **A. D.**, me detyrë specialiste finance

3- **K. M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të PZHT

4- **B. K.** me detyrë jurist i bashkisë

5- **O. R.** me detyrë specialist transporti

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në aplikimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 *oKualifikimi ofertuesve* të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *oPër prokurimin publik* i ndryshuar; neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin* dhe Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *oPër miratimin e rregullave të prokurimit publik* i ndryshuar, neni 26 *oKontrata për punë publike*, pika (5); neni 61 *oHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, pika (2), paragrafi (2) (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 32-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda datës 30.3.2022

6- A. Th., me detyrë specialist i SPZHT

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të operatorëve ekonomik me kritere të paplotësuara sipas kërkesave të DST, për të cilat KVO-ja duhej ti kishte rekomanduar Titullarit AK anulimin e procedurave të prokurimit, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) *“Anulimi një procedure prokurimiö*, pika (1), germa (ç); neni (46) *“Kualifikimi i ofertuesveö*, pika (1); neni (53) *“Shqyrtimi ofertaveö*, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) *“Kriteret e përcaktimit të ofertës fitueseö*, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publikö* i ndryshuar dhe neni (66) *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveö*, pika (3); neni (67) *“Klasifikimi ofertave;* neni (68) *“Raporti për mbledhësö; Kru (VIII) “Kushte të përgjithshme për zbatimö; neni (73) “Mungesa e konkurrencësö, pika (1) të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 32-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Brenda datës 30.3.2022

E/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, shkronja òëö dhe ôçö të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 *“Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, ö, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Delvinë, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSHósë, për periudhën 01.01.2020 deri më 30.6.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga öVërejtjeö deri në öLargim nga punaö për **5 (pesë) punonjës**, si më poshtë:*

1- A. T., me detyrë juriste Bashkia Delvinë

2- M. B. me detyrë shef kabineti (ekonomist)

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, në aplikimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, apo shërbejnë edhe si pengesë për konkurrencën e hapur, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 *“Kualifikimi ofertuesveö* të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publikö* i ndryshuar; neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö* dhe Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö* i ndryshuar, neni 26 *“Kontrata për punë publikeö, pika (5); neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö, pika (2), paragrafi (2) (Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 26-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Brenda datës 30.3.2022

3- P. B. me detyrë Përgjegjës i IMTV

4- B. M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie

5- G. L. me detyrë Drejtor i Njësisë së Shërbimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të operatorëve ekonomik me kritere të paplotësuara sipas kërkesave të DST, për të cilat KVO-ja duhej ti kishte rekomanduar Titullarit AK anulimin e procedurave të

prokurimit, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) *ōAnulimi një procedure prokurimiō*, pika (1), germa (ç); neni (46) *ōKualifikimi i ofertuesveō*, pika (1); neni (53) *ōShqyrtimi ofertaveō*, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) *ōKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseō*, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *ōPër prokurimin publikō* i ndryshuar dhe neni (66) *ōShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveō*, pika (3); neni (67) *ōKlasifikimi ofertave*; neni (68) *ōRaporti përmbledhësō*; Kreu (VIII) *ōKushte të përgjithshme për zbatimō*; neni (73) *ōMungesa e konkurrencësō*, pika (1) të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014 *ōPër miratimin e rregullave të prokurimit publikō*, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III/2.3 faqe 32-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda datës 30.3.2022

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarre veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 *ōPër Nëpunësin Civilō*, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 *ōPër Nëpunësin Civilō*, të ndryshuar.

G. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **2 ish-punonjësit** e mëposhtëm, ndajë të cilëve nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, *konkretisht:*

1. **K. T.**, me detyrë ish- Specialist në SPZHT, në cilësinë e anëtarit të KVO.
2. **A. F.** me detyrë ish- Përgjegjës i sektorit të tatim taksave vendore për periudhën e auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

PASQYRAT ANEKS QË SHOQËROJË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT NË SUBJEKTIN BASHKIA DELVINË

Aneksi 2.2

Llogaria 212 *Ëndërtimë konstruksione* paraqitet në vlerën 187,668,241 lekë

Nr	EMERTIMI	Vlera
1	Ambulanca Tip A2	996,700
2	Çerdhja e fëmijëve	39,206,695
3	Qendër shëndetësore Stjar	992,208
4	Zyrat e bashkisë	11,323,669
5	Ndërtesa te Ish Brigada e Këmbësorisë Delvine	2,537,000
6	Shkolla e mesme	533,100
7	Thertorja	2,337,680
8	Muzeu Delvine	9,939,759
9	Ambulanca Vane	1,044,850
10	Ambulanca Lefterohor	986,498
11	Shtëpia e Kultures	4,325,117
12	PolikliN.... Delvinë kati I dyte	1,984,413
13	Shkolla CU Vllahat	1,980,593
14	Shkolla "K. Çavo"	19,845,270
15	Rikonstruk.fasadeve ne qendër qytetit	8,543,273
16	Shkolla CU+Kopesht Bamatat	16,137,668
17	Lulishte qendër qytetit	756,840

Nr	E M E R T I M I	Vlera
18	Rikonstruksion I kopshtit Papuçi	183,375
19	Guri I Pavarësisë	480,000
20	Rrethim I Varrezave Fshati Blerimas	389,558
21	Shkolla Blerimas	1,110,733
22	Shkolla Blerimas + Kopshti (Ndërtesa e re)	17,056,225
23	Shkolla 9-Vjecare "Seit Gaci"Stjar	2,789,088
24	Shkolla 9-Vjecare "Xhelal Berberi"	441,520
25	Shkolla 9-Vjecare Bajkaj	2,457,160
26	Godina e Zjarrfikëses Delvine	1,450,000
27	Ndërtesa stacione ujitjeje	1,307,656
28	Njësia Administrative Vergo	35,701,193
29	Peme dekorative Njësia Administrative Vergo	119,520
30	Mure mbajtëse Lagjja Lejla Malo	710,880
	Shuma	187,668,241

Burimi: Bashkia Delvinë

Aneksi 2.2/1

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisjen, vegla puneö paraqitet në vlerën 11,614,150 lekë

Nr	E M E R T I M I	Vlefte
1	Instalime ne rrjetit e ndricimit rugës "V.Kallapodhi"	1,598,640
2	Instalime ne rrjetit e ndricimit te fshatrave	4,834,908
3	Instalimi I sinjalizuesve te zjarrit	280,000
4	Makine korrese bari	75,000
5	Makine korrese bari	50,000
6	Linje tensioni I ulet prane Shkolles "K.Çavo"Delvine	98,712
7	Instalim sherbimi logjistik ne shk.S.Delvina"	115,674
8	Linja Elektrike Fshati Blerimas	399,830
9	Aparat frymemarje Interspiro spiromatik 90 me aparat per mushkri MAS -N200	35,000
10	Pajisje hidraulike shpetimi	105,000
11	Agregat per energji elektrike 5 KVA	175,000
12	Makineri pajisje stacione pompimi	180,406
13	Kazan Metalik me kapak	448,560
14	Njësia Administrative Vergo	80,974
15	Aparat saldimi elektronik 200W	26,400
16	Fresibel 2600ë,2300MM,11000RPM 2 cop	30,000
17	Trapan dore me bateri 18v,1.5 A 1500RPM 2 cop	21,600
18	Trapan dore elektrik 550W (220-230)V cop 2(dy)	24,000
19	Betoniere me motor fuqi 6.5 hp kapaciteti 190 I	80,400
20	Matrapik godites dhe shpues 705 E metal 13mm/goditje	39,600
21	Kosha mbeturinash 1100 lt	2,187,528
22	Kosha mbeturinash 1100 lt	726,918
	Shuma	11,614,150

Burimi: Bashkia Delvinë

Aneks nr. 2.2/3

Fatura të likuiduara jasht afatit 30 ditorë

Periudha	Nr. Date Fature	Vlera	Nr/USH	Vlera
Maj 2020	Nr. Date 07.09.2019	1,425,000	177,dt.19.05.20	1,425,000
Maj 2020	Nr. Date 01.08.2019	475,000	178,dt.19.05.20	475,000
Maj 2020	Nr. Date 09.03.2020	119,000	188,dt.19.05.20	119,000
Qershor 2020	Nr. 71, Date 03.03.2019	100,000	216,dt.02.06.20	100,000
Qershor 2020	Nr. 45,dt.31.01.19,nr.3,dt.31.01.20,nr.11, Date 12.04.2020	96,000	217,dt.02.06.20	96,000
Qershor 2020	Nr.108,dt.30.04.2019	384,812	226,dt.03.06.2020	384,812

Periudha	Nr. Date Fature	Vlera	Nr/USH	Vlera
Qershor 2020	Listepagesa Date 28.02.2020	167,014	224,dt.03.06.2020	167,014
Qershor 2020	Listepagesa Date 31.03.2020	307,377	225,dt.03.06.2020	307,377
Qershor 2020	Nr. 60, Date 15.02.2020	465,600	227,dt.03.06.2020	465,600
Qershor 2020	Nr. 27, Date 12.12.2019	230,112	223,dt.03.06.2020	230,112
Qershor 2020	Nr. 132, Date 31.05.2019	276,332	236,dt.17.06.2020	276,332
Qershor 2020	Nr. 313, Date 28.02.2019	25,069	237,dt.17.06.2020	25,069
Qershor 2020	Nr. 3, Date 25.04.2019	1,472,000	234,dt.17.06.2020	1,472,000
Qershor 2020	Nr.9, Date 08.07.2019	174,306	241,dt.17.06.2020	174,306
Gusht 2020	Nr.152, Date 28.12.2018	119,502	324,dt.12.08.2020	119,502
Gusht 2020	Listpages Date 01.07.2018	439,566	325,dt.12.08.2020	439,566
Gusht 2020	Nr. 6, Date 31.05.2019	1,500,000	326,dt.12.08.2020	1,500,000
Shtator 2020	Nr.1, Date 26.06.2019	96,000	359,dt.02.09.2020	96,000
Shtator 2020	Nr.29,30, Date 03.06.2019	117,720	358,dt.02.09.2020	117,720
Tetor 2020	Nr. 143, Date 30.06.2019	276,332	398,dt.14.10.2020	276,332
Tetor 2020	L/pag. dt.30.06.2020	329,332	401,dt.20.10.2020	329,332
Nentor 2020	Nr.10,dt.10.08.2020	1,870,000	451,dt.24.11.2020	1,870,000
Nentor 2020	Listepagesat Maj 2020	480,550	453,dt.24.11.2020	480,550
Nentor 2020	Nr.137,529,212,dt.31.10.18;Nr.151,231,dt.30.11.18,Nr.165,dt.31.12.2018	55,518	450,dt.24.11.2020	55,518
Nentor 2020	Nr.20,dt.31.08.2020	99,000	452,dt.24.11.2020	99,000
Nentor 2020	Nr.319,dt.31.03.2019	242,500	447,dt.13.11.2020	242,500
Nentor 2020	Nr.124,dt.24.07.2019	1,171,680	445,dt.12.11.2020	1,171,680
Nentor 2020	Nr.14,dt.02.12.19,Nr.15,dt.10.12.19,Nr.18,dt.28.01.20,Nr.28,dt.28.01.20,Nr.29,dt.28.02.20	113,565	438,dt.04.11.2020	113,565
Nentor 2020	Nr.72,dt.24.08.20	316,800	431,dt.03.11.2020	316,800
Dhjetor 2020	Nr.71118268,dt.29.03.2019	320,400	495,dt.21.12.2020	320,400
Dhjetor 2020	Nr.40,dt.06.07.20	119,280	504,dt.22.12.2020	119,280
Totali		13,264,298		13,264,298

Burimi: Bashkia Delvinë

Aneks nr. 2.2/4

Fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë.

PERIUDHA	Nr/datë fature	Shuma	Nr/USH	Vlera	Diferenca
Viti 2020	Nr.15,dt.09.07.2019	6,214,296	177,dt.19.05.20	1,500,000	4,714,296
9/Mujori	Nr.15,dt.09.07.2019	4,714,296	127,dt.21.04.21	750,000	3,964,296
Viti 2020	Nr.18,dt.01.08.2019	4,895,210	178,dt.19.05.20	500,000	4,395,210
9/Mujori	Nr.18,dt.01.08.2019	4,395,210	128,dt.21.04.21	500,000	3,895,210
Viti 2020	Nr.71,dt.30.03.2019	199,999	216,dt.02.06.20	100,000	99,999
Viti 2020	Nr.3,dt.25.04.2019	4,315,956	234,dt.17.06.20	1,472,000	1,343,956
9/Mujori	Nr.3,dt.25.04.2019	1,343,956	317,dt.24.09.21	821,000	522,956
Viti 2020	Nr.116,dt.10.07.2019	5,337,696	275,dt.14.07.20	1,816,000	3,521,696
Viti 2020	Nr.116,dt.10.07.2019	3,521,696	318,dt.14.09.21	1,850,000	1,671,696
Viti 2020	Nr.28,dt.01.11.2020	2,008,476	444,dt.12.11.20	2,000,000	8,476
Viti 2020	Nr.10,dt.10.08.2020	2,396,400	451,dt.24.11.20	1,870,000	526,400
Viti 2020	Nr.48,dt.02.12.20	3,179,256	485,dt.03.12.20	2,900,000	279,256
9/Mujori	Nr.48,dt.02.12.20	279,256	131,dt.21.04.21	279,259	0
Viti 2020	Nr.177,dt.07.12.2020	1,169,280	486,dt.10.12.20	1,026,000	143,280
Viti 2020	Nr.34,dt.01.12.2020	1,788,600	487,dt.10.12.20	1,730,000	58,600
9/Mujori	Nr.34,dt.01.12.2020	58,600	314,dt.14.09.21	58,600	0
9/Mujori 2021	Nr.8,dt.09.06.2019	3,026,874	Nr.126,dt.21.04.2021	750,000	2,276,874
9/Mujori 2021	Nr.1,dt.13.02.2021	879,690	315,dt.14.09.21	500,000	379,690
9/Mujori 2021	Nr.75,dt.18.05.2021	275,100	Nr.235,dt.14.07.2021	75,100	200,000
9/Mujori 2021	Nr.3,dt.15.07.2021	983,827	Nr.244,dt.27.07.21	500,167	483,660
9/Mujori 2021	Nr.1,dt.05.12.2020	4,788,048	Nr.313,dt.14.09.21	2,500,000	2,288,048
9/Mujori 2021	Nr.17,dt.14.05.2019	1,499,760	Nr.319,dt.15.09.21	100,000	1,399,760

Burimi: Bashkia Delvinë

Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2020:

Nr	E m ë r t i m i	Progresivi 31.12.2020		
		Plan	Fakt	%
a	Te ardhura nga taksat	49,981	15,621	31
1	Taksa mbi token bujqesore	32,486	4,408	14
2	Taksa mbi ndertesat	5,107	2,954	58
3	Taksa e tat.thj.fit.(DRTSarande)	280	286	102
4	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	810	855	106
5	Taksa e rregj. pervitshem te automj.	4,500	4,692	104
6	Takse e tabelës	28	28	100
7	Takse e tregut	70	25	36
8	Takse trualli	6,700	2,373	35
b	Te ardhura nga tarifat	13,920	8,794	63
1	Tarifa e parkimit te mjeteve	314	300	96
2	Tarifa per sherbime administrative	600	252	42
3	Tarifa e sherbimeve publike	12,196	7,835	64
4	Tarifa per ujitjen e tokave bujqesore	370	160	50
5	Tarife per zenien e hapësirave publike	140	105	75
6	Tarifa per Cerdhe	300	142	47
c	Te ardhura nga asetet dhe vepr. Ekonomike	17,262	14,094	82
1	Qera objekti	400	500	125
2	Qera kullote	6,500	6,745	104
3	Qera toke	2,040	1,451	71
4	Qera Trualli	620	3,368	543
5	Licensa transp.+ Certifikata + Autori	1,550	932	60
6	Leje ndertimi/zhvillimi/kryerje punimesh	390	902	231
7	Gjoha te Policise Bashkiake	12	0	0
8	Kamat Vonesa + Deb. KLSH (113.600)	0	6	0
9	Te ardhura nga shitje e pronave	3,500	0	0
10	Dru zjarri e bime medicinale etj	2,250	190	8
d	Shuma gjithesejte (a+b+c)	81,163	38,509	47

Burimi: Bashkia Delvinë

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, të pozicionit financiar Bashkia Delvinë; Formati nr.1.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	1,123,810,139	1,088,394,921
2		I.Aktivet Afat shkurtra	215,852,446	197,122,987
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	35,034,622	20,476,424
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	35,034,622	20,476,424
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlerësim i letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	29,305,318	29,082,433

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
12	31	Materiale	721,141	1,075,540
13	32	Inventar I imet	28,584,177	28,006,893
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	99,721,202	84,352,178
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te 57ebit shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	76,557,191	74,817,699
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	23,164,011	9,534,479
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo 57ebitor ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	51,791,304	63,211,952
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per tçu shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	51,791,304	63,211,952
42		II.Aktivet Afat gjata	907,957,693	891,271,934
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	0	0
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	0	0
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	907,917,733	891,231,974
48	210	Toka, T,roje, Terene	52,081,640	52,081,640
49	211	Pyje, Plantacione	4,500,000	4,500,000
50	212	Ndertesa e Konstruksione	151,425,530	157,679,139
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	678,648,382	658,434,590
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	5,735,880	2,969,931
53	215	Mjete Transporti	9,818,723	9,282,866
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	5,707,578	6,283,808
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	39,960	39,960
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	39,960	39,960
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	160,929,174	156,849,413
66		I.Pasivet Afat shkurtra	160,929,174	156,849,413

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
67		1. Llogari te Pagushme	160,929,174	156,849,413
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,086,415	2,690,891
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,546,178	6,553,814
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	458,065	949,529
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi 58 natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	1,966,994	1,788,358
76	436	Sigurime Shendetsores	265,980	242,778
77	437,438,	Organizma te 58ebit shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo 58ebitor ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	9,416,668	9,285,283
82	467	Kreditore te ndryshem	63,631,683	60,521,061
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	76,557,191	74,817,699
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtushme para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	962,880,965	931,545,508
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	962,880,965	931,545,508
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	937,263,011	920,354,367
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	25,617,954	11,191,141
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		0
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		0
105	107	Vlera e 58ebitor te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	1,123,810,139	1,088,394,921
K O N T R O L L E				
		Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen	Kuadratura	Kuadratura
Kontroll 1.		Aktivet Neto a 58ebi te barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
Kontroll 2.		Totali I Aktiveve a eshte i barabarte me = Totalin e Pasiveve	0	0

Shënim: Të dhënat janë të disponuara nga Pasqyrat financiare

Pasqyra e procedurave të prokurimit, peiudha 01.01.2020 – 30.6.2021

Nr	Objekti	Lloj proced	Vlera fond limit pa TVSH	Burim financimi	OE pjesmarrës		Kontrata bazë pa TVSH	Vleresuar për auditim	Shkelje sipas natyrës
					Gjithsej	Skualif			Kritere/Vlerësim
1	Blerje karburanti diesel dhe benzinë viti 2020	KP	6,833,334	Grande	1	0	6,833,334	PO	kritere
2	Blerje materiale ndërtimi, elektrike, hidraulike, e të tjera, për mirëmbajtje rrugë, rrjete dhe kanale kulluese	KP	2,085,000	Grande/Bashkia	5	4	1,996,700	PO	vleresim
3	Ndertim i kopshtit per femije,Fshati Bajkaj,Bashkia Delvine	KP	1,250,000	Grande/Bashkia	2	1	1,237,340		
4	Ndertim KUZ-je,Fshati Stjar,Bashkia Delvine	KP	1,230,000	Grande/Bashkia	4	3	1,102,400		
5	Rikonstruksion i Muzeut Historik Delvine	KP	1,473,970	Buxheti,Qarku Vlore	3	2	1,374,008		
6	Rikonstruksion i Muzeut Historik Fshati Senise,Njesia Administrative Vergo	KP	833,334	Buxheti/Ardhura	3	2	732,690		
7	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në fshatrat e Bashkisë Delvinë	KP	3,299,327	Buxheti/Ardhura	3	2	3,231,280	PO	vleresim
8	Rikonstruksion i Rrugeve te brendshme ne Fshatrat e Njesise Administrative Vergo	KP	1,583,325	Buxheti/Ardhura	1	0	1,490,500		
9	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të qytetit Delvinë	KP	5,832,014	Buxheti/Ardhura	2	1	5,663,990	PO	
10	Rikonstruksion Shesh pushimi ,Rruga Javer Malo,Bashkia Delvine	KP	1,666,667	Buxheti/Ardhura	2	1	1,588,900		
11	Shtretese asfalti i rruges FusheVerri-Kalase dhe i rruges Blerimas-Finiq	H	37,500,000	Buxheti/Ardhura	2	1	35,908,460	PO	Kritere/vleresim
1	Blerje materiale elektrike për mirëmbajtje godina	KP	1,250,000	Vetë Financim	3	1	1,148,695		0
2	Blerje materiale ndërtimi për rrugë e rrjete	KP	3,637,639	Buxheti Shtetit	3	0	3,470,000	PO	0
3	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara, B, Delvinë	H	6,176,639	Buxheti Shtetit	4	0	4,610,016	PO	0
Totali 2020 + 2021			74,651,249	-	38	18	70,388,313	64,778,386	-

Burimi: Bashkia Delvinë